



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 521/5 prot.

Tiranë, më 11 . 10 . 2023

V E N D I M

Nr. 199, datë 11 . 10 . 2023

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja b), të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹, mori në shqyrtim ankesën nr. 66 Regj., datë 24.04.2023, paraqitur nga Shoqata “Për Drejtësi Sociale” kundër S. N, dhe emisionit “Më lër të flas” në televizionin Top Channel, në të cilën pretendohet për diskriminim në formën e “gjuhës së urrejtjes”, për shkak të gjinisë.

Në përfundim të shqyrtimit të çështjes, Komisioneri,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, subjekti ankues informon se:

“Në emisionin “Më lër të flas” të datës 14.04.2023, të transmetuar në televizionin Top Channel, i cili kishte si tematikë diskutimi tradhëtinë është zhvilluar dialogu i mëposhtëm:

.....

S. N: - Sipas legjislacionit anglez, nuk mund ta akuzosh ti tjetrin për përdhunim në rast se nuk ke rezistuar.

Prezantuesi 1: Duhet t’i kërkosh leje a mund të të përdhunoj?

Prezantuesi 2: Me mesazh do të përdhunoj sot nga ora 4.

S. N: Eshtë dhe scherzo e vajzës që bën sikur jo. Të akuzojnë X për përdhunim, në bazë të së drejtës penale angleze, ata matin sa e ke segmentin e rezistencës. Sepse vjen një moment i

¹ Në vijim referuar me akronimin KMD ose si Komisioneri.

caktuar që femra...pasi femra është shtrënguar për përdhunim, dorëzohet nga kënaqësia. Prandaj duhet të jetë e lartë rezistenca që të dënohet.

....

E dini ju se çfarë thotë ligji anglo-sakson? Ata kur dënojnë një person që përdhunon një vajzë, grua apo zonjë, marrin parasysh rezistencën e saj. A i ka rezistuar ajo ndaj kësaj tentative apo jo. E dini pse? Sepse gratë janë natyra më të dobëta, ata nuk rezistojnë dot, madje ndjejnë kënaqësi dhe në momentin që përdhunohen dhe më pas dorëzohen.”

Për sa më sipër, Shoqata konsideron se në dialogun e transkriptuar më lart, është përdorur gjuhë urrejtjeje dhe denigruese e cila prek në mënyrë të drejtëpërdrejtë gratë, duke u shprehur se:

“Pyetjet dhe shprehjet e përdorura tregojnë seksizëm ku theksohet një dallim gjinor pa bazë shkencore dhe nxitet dhuna ndaj njëres gjini.... duke nënkuptuar se nëse shtrëngohen sa duhet femrat do të kenë kënaqësi gjatë përdhunimit, duke dizinformuar kështu publikun për ligjin anglez për dhunën seksuale, duke e deformuar totalisht atë.”

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit që është bërë ndaj grave gjatë transmetimit të emisionit televiziv “Më lër të flas”, në televizionin Top Channel.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e çështjes nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se:

“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Neni 7 i LMD-së, i ndryshuar, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi ose grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim.”

Bazuar në nenin 32/1/b të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

Përsa më lart, referuar në nenin 32, pika 2 dhe 33, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

Plotësimi i kriterëve formale të një ankese, për të vijuar me shqyrtimin administrativ të saj, është hapi i parë, që ndiqet nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në bazë parashikimeve përkatëse ligjore. Ky detyrim i Komisionerit parashikohet shprehimisht në ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, si dhe në ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë.

Mbështetur në parashikimin e nenit 44, pika 2, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, organi publik shqyrton paraprakisht kërkesën e depozituar nga pala, lidhur me përmbushjen e kriterëve formale ligjore, si kompetenca e organit publik, legjitimimi, afati, forma dhe çdo kriter tjetër të parashikuar nga ligji.

Në nenin 65, shkronja b), të ligjit të sipërpërmendur parashikohet gjithashtu se: “Në fillim të procedurës administrative, organi publik kryen verifikimet e mëposhtme:

.....

b) legjitimitimin e palës që ka paraqitur kërkesën për fillimin e procedurës administrative.”

Në pikën 1, të nenit 128, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, gjithashtu parashikohet koncepti i legjitimitit edhe kur pala legjitimohet për të nisur një procedim administrativ. Sipas këtij neni, pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet ligjore administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj të ligjshëm cenohen nga ky veprim apo mosveprim.

Në rast se do t’i referohemi LMD-së, rezulton se në nenin 32, pika 1, të tij parashikohet shprehimisht se:

“1. Komisioneri ka kompetencë:

a) të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, siç parashikohet në këtë ligj;

b) të shqyrtojë ankesat nga organizatat që kanë një interes të ligjshëm për të vepruar në emër dhe me pëlqimin me shkrim të individëve ose grupeve të individëve që pretendojnë se ka ndodhur diskriminimi ose në emër të tyre për çështje që lidhen me interesa kolektive;

c) të kryejë hetime administrative pas marrjes së informacionit të besueshëm për shkelje të këtij ligj.”

Referuar parashikimit të shkronjës b), të pikës 1, të nenit 32, të ligjit të sipërpërmendur rezulton se Komisioneri shqyrton ankesat nga organizatat që kanë një interes të ligjshëm për të vepruar në emër dhe me pëlqimin me shkrim të individëve, ose në emër të tyre për çështje që lidhen me interesa kolektive.

“Interesi i ligjshëm” është elementi fillestar që duhet të plotësohet nga një organizatë, që depoziton ankesë pranë Komisionerit, për mbrojtje të interesave të një komuniteti të caktuar, që nënkupton legjitimitimin e saj në kryerjen e ankesës.

Referuar Vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me nr. 6599, datë 14.12.2020, nëpërmjet së cilit Shoqata “Për Drejtësi Sociale”, është regjistruar si person juridik, si dhe Statutit të saj, konstatohet se objekti kryesor i veprimtarisë së kësaj shoqate është mbrojtja dhe promovimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut (dhe veçanërisht grupeve: rome-egjiptiane, personave me aftësi të kufizuara, grua, fëmijë, etj).

Mbështetur në përmbajtjen e aktit të regjistrimit dhe Statutit të Shoqatës, rezulton se forma e organizatës jofitimprurëse, është ajo e Shoqatës, parashikuar në ligjin nr. 8788, datë 07.05.2001 “Për organizatat jofitimprurëse” dhe objekti kryesor i veprimtarisë së Shoqatës, ndër të tjera është si më poshtë:

- *Të mbrojtë të drejtat e liritë themelore të çdo personi në Shqipëri (veçanërisht grupet egjiptian, rom, aftësi e kufizuar, grua, besimtarë, etj);*
- *Të advokojë dhe të mbrojtë, në mënyrë proaktive, së bashku me aktorë të tjerë të shoqërisë civile, organizata kombëtare dhe ndërkombëtare, respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në Shqipëri;*
- *Të nxisë llogaridhënien e administratës publike në zbatimin korrekt dhe efektiv të legjislacionit nëpërmjet denoncimit publik të cenimit të lirive dhe të drejtave të shtetasve që u përkasin grupeve në nevojë, referimit të tyre tek organet e drejtësisë shqiptare deri në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ose të shkëlqeve të kryera, sipas rastit;*
- *Të punonjë për përmirësimin e legjislacionit, politikave dhe standardeve për të drejtat themelore të njeriut në Shqipëri;*
-
- *Të kontribuojë në edukimin dhe sensibilizimin e publikut për rëndësinë e mediave në ndërtimin dhe ruajtjen e një demokracie ligjore dhe funksionale;*
- *Të promovojë nisma për afirmimin e të drejtave themelore të individëve dhe favorizimin e integritit mediatik dhe social të kategorive në nevojë, nëpërmjet medias online Informim.al;*
- *Të mbështesë me këshillim dhe teknikë mediatike nisma të ndryshme sociale nga komunitete dhe organizata jo fitimprurëse me akses të kufizuar mediatik;*
- *Të zhvillojë dhe forcojë bashkëpunimin me partnerë, të tjera subjekte publike dhe private, institucione mediatike, institucione që ushtrojnë veprimtari social-kulturore apo që kanë qëllime të ngjashme dhe që i bashkon misioni dhe qëllimet;*
- *Të këshillojë institucione publike dhe subjekte të tjera për çështje të hartimit të politikave të ndryshme mediatike;*
- *Të promovojë zhvillimin e gazetarisë qytetare në Shqipëri dhe të fuqizojë zëra të përgjegjshëm qytetarë, sidomos nga grupet në nevojë, në përputhje me vlerat e një shoqërie gjithëpranueses, tolerancës dhe lirive e të drejtave të njeriut.”*

Qëllimi kryesor i Shoqatës, sipas parashikimit të bërë në nenin 2, të Statutit, është: “... të punojë për arritjen e zhvillimit të shoqërisë në atë nivel ku qytetarët, pavarësisht nga veçoritë ose dallimet sociale, ekonomike, racore, ideologjike, krahimnore, identiteti gjinor dhe në çdo aspekt tjetër midis tyre, ushtrojnë lirisht të drejtat dhe liritë e tyre themelore dhe aksesojnë në mënyrë të barabartë shërbimet publike, në përputhje me standardet kushtetuese dhe ato ndërkombëtare.”

Referuar Vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me nr. 6599, datë 14.12.2020, si dhe Statutit të Shoqatës, G. S është zgjedhur Kryetar i Shoqatës², e cili bazuar në kompetencat e parashikuara në nenin 10, të Statutit, ka tagrin e përfaqësimit të Shoqatës në marrëdhënie me institucione të ndryshme dhe me persona të tretë.

Në këtë kontekst, theksojmë faktin se në bazë të pikës 1, të nenit 4, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ky ligj zbatohet për të gjithë personat, që jetojnë dhe qëndrojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë, të cilët janë e ndjehen pjesë e grupeve të mbrojtuar nga kjo Shoqatë. Mbështetur në objektin e veprimtarisë së Shoqatës, sipërcituar në vendim, Komisioneri gjykon se Shoqata, përfaqësuar nga G. S. (Kryetar i Shoqatës) legjitimohet dhe ka tagër për të bërë ankesë në emër të mbrojtjes së të drejtave të grave, si pjesë e grupit të mbrojtur prej tyre.

1. Nëpërmjet shkresës me nr. 521/1 prot., datë 26.04.2023, Komisioneri ka njoftuar dhe kërkuar parashtrime nga S. N dhe Tv Top Channel, lidhur me pretendimin e subjektit ankues.
- Në vijim, nëpërmjet shkresës me nr. 357/1 prot, datë 05.05.2023, Tv Top Channel, ka njohur Komisionerin me qëndrimin e tij lidhur me pretendimet e subjektit ankues, duke cituar ndër të tjera, se:

“...Shoqëria “Top Channel” nuk mund të mbajë përgjegjësi për fjalët që mund të përdorin të ftuarit përgjatë zhvillimit të programit. Megjithatë për shkak të gjuhës së përdorur nga z. N, në emisionin “Më lër të flas”, të datës 14 prill 2023, është marrë si masë që z. N mos të jetë më prezent në emision, në asnjë prej puntatave në vazhdim. Gjithashtu të ftuarit dhe moderatorët e kanë kundërshtuar qëndrimin e z. N duke mos u pajtuar me të.

Në zbatim të nenit 7, të LMD-së, shoqëria “Top Channel” ka ndërmarrë të gjitha veprimet e duhura në respektim të të drejtave të njeriut dhe mosdiskriminimit të tyre, duke u distancuar nga qëndrimet personale, sikurse rasti i z. N.”

- Nëpërmjet shkresës kthim-përgjigje, datë 27.04.2023, drejtuar Komisionerit, z. N ka parashtruar argumentat e tij, lidhur me pretendimet e subjektit ankues, duke cituar ndër të tjera, se:

² Me një mandat 3 vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr.27, Kodi Postar 1001, Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: info@kmd.al, web: www.kmd.al

“...Institucioni juaj nuk është kompetent për të Drejtën Penale; për faktin që, merreni me emisionin në të cilin është folur për të Drejtën Penale Angleze dhe nuk pyesni profesionistët.

...e Drejta Penale është shkencë e jurisprudencës dhe nuk ka lidhje fare me të folurin komun, apo me ato që ju konceptoni si koral, jashtë shkencës së të Drejtës Penale.

E drejta Penale, zotëri, parashikon edhe gënjeshtren e asaj vajzës apo gruas që bën sikur, e cila, gjithashtu, është krim për kallëzim të rremë.

Në funksion të kësaj, ju vë në dijeni se:

E Drejta Penale Angleze, me autor J. Herring-botim shqip i Universitetit Europian të Tiranës, në volumnin e I, botimi i pestë, kapitulli 7, të tij, në faqet 421-499, ka veprat penale seksuale, në të cilin keni shumë më tepër nga ato që keni dëgjuar në televizion prej meje.

Në historinë e goditjes penale ka shumë vajza apo gra që gënjejnë – e dini ju këtë?

Dhe, e dini ju se, çfarë është drejtësia?

Zotëri, drejtësia është provë gjyqësore dhe jo mashtrim rrugësh; dhe godet edhe kallëzimin e rremë. Pikërisht për këtë është edhe karakteri shkencor i rezistencës së vajzës apo gruas në çështje të tilla, të cilën na sqaron teorikisht dhe shkencërisht, në funksion të psikologjisë njërzore. E Drejta Penale që ju citova.”

2. Mbështetur në nenin 33, pika 8, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të kësaj ankese, Komisioneri, nëpërmjet shkresës me nr. 521/4 prot., datë 04.07.2023, njoftoi dhe ftoi palët për pjesëmarrje në seancë dëgjimore, pranë Zyrës së Komisionerit.

Seanca dëgjimore u zhvillua në datën 19.07.2023, pranë Zyrës së Komisionerit, me praninë e përfaqësuesve të palës ankuese: G. S, Kryetar i Shoqatës dhe Gj. B³, me profesion juriste, si dhe të palëve kundër të cilës është paraqitur ankesa: av. S. N, personalisht dhe përfaqësuesve të Top Channel, S. S dhe L. B⁴.

Bazuar në nenin 80/1/b të Kodit të Procedurave Administrative dhe Rregullores së Brendshme të Komisionerit, seanca dëgjimore u regjistrua audio dhe përmbajtja e saj do të përdoret si provë gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës.

Në deklaratimet e bëra gjatë seancës, palët mbajtën të njëjtin qëndrim, si ai i komunikuar shkresërisht Komisionerit.

Nga ana e përfaqësuesve të Tv Top Channel, u theksua fakti se nga ana e tyre janë marrë masat paraprakisht që të hiqet pjesa ku av. N shprehet për sa është ankuar Shoqata, dhe se nga ana e tyre do të merren masa paraprakisht që të ftuarit nëpër emisione të ndryshme, të nënshkruajnë një

³ Sipas Autorizimit me datë 18.07.2023, të Shoqatës “Për Drejtësi Sociale”.

⁴ Sipas emailit zyrtar: l.b@top-channel.tv www.top-channel.tv

deklaratë tip që ata kanë dhe e përdorin në shumë raste, me persona të ftuar në emisione të ngjashme.

Nga ana e palës ankuese u vlerësuan masat e ndërmarra nga ana e Tv Top Channel dhe u kërkua që nga ana e televizionit të zbatohet ligji për mediat audiovizive lidhur me gjuhën e përdorur nga drejtuesit e emisooneve por edhe të ftuarit e tyre, duke patur në konsideratë mesazhin që përçohet për publikun që i ndjek.

Av. N, ndër të tjera, mbajti qëndrimin se⁵:

“...pikëpamja ime është ajo e së drejtës penale anglo-saksone. Sipas të drejtës anglo-saksone, matet masa e rezistencës ndaj përdhunimit. Kam qenë i ftuar si jurist në këtë emision, më kanë thirrur për të folur për temën e tradhëtisë dhe përdhunimit. Jam thirrur për këto dy tema. Unë kam shprehur pikëpamjet sipas Jonathan Herring, lidhur me përdhunimin. Unë nuk mbaj përgjegjësi për shkencën. Është një praktikë 20 vjeçare në Angli. Gjykata dhe gjykatësit duhet të dinë të dallojnë hakmarrjen e gruas ndaj burrit, nga përdhunimi. Kjo teori është studiuar në universitete. E drejta penale e Jonathan Herring është përkthyer edhe nga Universiteti Evropian i Tiranës/UET. Në Shqipëri nuk kuptohet “përdhunimi” sepse i është lënë në dorë hetimit. Unë të kam sjellë katedrën më të madhe të së drejtës penale.

.... Kam cituar fjalë nga libri i Jonathan Herring. Teoria që kam shprehur ngre personalitetin e femrës dhe gjuha që kam përdorur është “E drejta penale” e Jonathan Herring.

Ku është urrejtja në gjuhën e përdorur? Ka scherzo (lojë, shaka) edhe përdhunimi, ku gruaja thotë nuk kam thënë “po”. Scherzoja ka një masë shumë të vogël rezistence. Përdhunimi ka një masë më të madhe rezistence.”

Nga ana e subjektit ankues, u cilësua se nëse nga ana e z. N do të kishte një ndjesë publike lidhur me sa është perceptuar e keqpërcjellë në publik, ata do të tërhiqeshin nga ankesa e bërë pranë Komisionerit.

Në këto kushte, në përfundim të seancës, palëve kundrejt të cilave ishte paraqitur ankesa: av. N dhe Tv. Top Channel iu la një afat kohor që të përcillnin pranë KMD-së informacion e prova lidhur me masat e ndërmarra prej tyre për rregullimin e situatës në fjalë.

3. Në vijim të seancës, nëpërmjet e-mailit datë 20.07.2023, Av. N dhe Tv. Top Channel iu dërgua procesverbalit i mbajtur gjatë seancës dëgjimore të datës 19.07.2023, duke i lënë një afat deri me datë 31.07.2023 lidhur me informimin e Komisionerit lidhur me masat e ndërmarra prej tyre specifikisht.
- Nga ana e Av. N nuk pati asnjë reagim apo informacion të dërguar Komisionerit lidhur me sa sipër cituar, në kuadër të masave të ndërmarra prej tij për kërkimin e ndjesës

⁵ Referuar deklaratimeve (procesverbalit) gjatë kësaj seance dëgjimore.

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr.27, Kodi Postar 1001, Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: info@kmd.al, web: www.kmd.al

publike lidhur me sa është perceptuar e përcjellë në publik në fjalën e tij gjatë emisionit “Më lër të flas” të datës 14.04.2023, të transmetuar në televizionin Top Channel.

- Njëpërmjet e-mailit të datës 26.07.2023, juristja L. B, e Tv Top Channel, informoi Komisionerin lidhur me masat e ndërmarra nga ana e tyre, si më poshtë citojmë:

“Në lidhje me linkun e këtij emisioni, sqarojmë se linku është bërë privat dhe nuk është i aksesueshëm nga publiku i gjerë;

Bashkëlidhur po dërgojmë deklaratën tip që kemi për të ftuarit dhe pjesëmarrësit në emisionet dhe programet e ndryshme të Top Channel.”

Komisioneri vëren se, Deklarata Tip e dërguar nga Top Channel, “Deklaratë personale e pjesëmarrësve në emision”, ka në përbërjen e saj 12 pika, ku i ftuari deklaron ta respektojë e zbatojë atë. Në pikën e 12-të të saj, përcaktohet se, i ftuari deklaron se nuk do të përdorë gjuhë urrejtje dhe diskriminuese, si dhe se do të mbajë përgjegjësi për deklaratat e tij ndaj çdo pretendimi nga palë të treta.

- Qëndrimet sa mësipër, i janë bërë të ditura njëpërmjet e-mailit, palës ankuese, e cila në vijim njëpërmjet e-mailit të datës 27.09.2023, ka informuar Komisionerin, ndër të tjera se:

“Për sa i përket masave të marra nga televizioni kombëtar Top Channel, Drejtësi Sociale, shprehet se dakordësohet për të tërhequr ankesën për sa kohë që video është prerë në segmentet ku z. N ka folur mbi përdhunimin, si dhe me masën e marrë që nuk do të ftohet më në emisionin “Më Lër të Flas”.

Në seancën dëgjimore, ne kërkuam që z. N të kërkonte ndjesë publike dhe të ndryshonte sjellja brenda afateve që u caktuan në seancë. Një gjë e tillë nuk ka ndodhur dhe ndaj, ne kërkojmë që KMD të vazhdojë me gjykimin e çështjes.

Po ju vëmë në dispozicion disa të dhëna të mbledhura nga rrjetet sociale në lidhje me çështjen. Video origjinale mund të shihet në instagramin e Piranja, në këtë link:

<https://www.instagram.com/reel/CrWTYdIsqGP/>

Av. N, i ftuar në këtë emision informativ (Breaking News), ka përsëritur të njëjtat fjali verbatim:

<https://www.youtube.com/watch?v=hmDXtt8I77o>

“E dini ju se çfarë thotë ligji anglo-sakson? Ata kur dënojnë një person që përdhunon një vajzë, grua apo zonjë, marrin parasysh rezistencën e saj. A i ka rezistuar ajo ndaj kësaj tentative apo jo. E dini pse? Sepse gratë janë natyra më të dobëta, ata nuk rezistojnë dot, madje ndjejnë kënaqësi dhe në momentin që përdhunohen dhe më pas dorëzohen.” (citim nga Av. N)

III. Legjislacioni i zbatueshëm.

Dinjiteti i njeriut dhe të drejtat dhe liritë e tij, janë bazat e shtetit të së drejtës. Detyrimi i shtetit është, jo vetëm të mos i cenojë vetë ato, por ai duhet të marrë masa dhe të ofrojë garancitë e duhura për të garantuar mos cënimin e tyre nga privatët, pra shteti duhet të marrë të gjitha masat për t'i mbrojtur dhe për të garantuar gëzimin e tyre nga të gjithë individët. (Neni 3, i Kushtetutës së Shqipërisë)

Liria e fjalës dhe e shprehjes konsiston në një të drejtë themelore të njeriut. Kjo e drejtë luan rol thelbësor edhe në realizimin dhe mbrojtjen e të drejtave të tjera të njeriut. Koncepti i qytetarisë dhe i pluralizmit janë të përcaktueshëm, nëse individëve nuk u jepet mundësia e shprehjes së lirë të mendimit. Toleranca ndaj mendimit të tjetrit dhe të ndryshmit, mundëson bashkëekzistencën në shoqëritë bashkëkohore multikulturore.

Pavarësisht sa më sipër, liria e shprehjes mund të keqpërdoret në situata të caktuara, duke sjellë si pasojë shkeljen e të drejtave të personave të tjerë. Në emër të “lirisë së shprehjes”, individë dhe grupe të caktuara mund të shprehin ide për superioritet të një race, feje apo etnie të caktuar, me qëllim përcëlimin e të gjithë atyre, që nuk i takojnë grupit “të tyre”, si dhe të bëjnë thirrje për ndjekje, izolim, po madje edhe deri për genocid ndaj tyre. Në raste të tilla, liria e shprehjes përbën shqetësim për kategori të caktuara individësh dhe shpesh kalon deri në gjuhë urrejtjeje ndaj tyre. Pikërisht, femoneme të tilla aktualizojnë diskutimin për lirinë e shprehjes, kufizimet e saj dhe keqpërdorimin e kësaj lirie.

Në mediat shqiptare, jo në pak raste, është konstatuar se kultura e fjalës së përdorur nuk është e duhura. Njëkohësisht, është vënë re jo në pak raste jemi ndeshur me fenomenin e nxitjes, përdorimit dhe përhapjes së “gjuhës së urrejtjes” në publik për kategori apo grupe shoqërore, pa reflektuar asnjë ndjenjë përgjegjësie për fjalën e thënë në median e shkruar dhe atë televizive.

Liria e shprehjes buron nga parashikimet përkatëse në aktet juridike ndërkombëtare dhe standardet minimale të saj rezultojnë të përcaktuara në aktet ndërkombëtare të detyrueshme në nivel të përgjithshëm ndërkombëtar dhe në nivel rajonal. Shtetet palë e kanë për detyrë t'i inkorporojnë të drejtat dhe liritë në legjisllacionin vendas dhe, në rast të cenimit të tyre, të mundësojnë mjete juridike për të rivendosur të drejtat e shkeluara.

Barazia dhe mosdiskriminimi, janë gur themeli i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Në nenin 18, të saj, Kushtetuta sanksionon: *“1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit. 2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore. 3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përligje e arsyeshme dhe objektive.”*

Barazia dhe mosdiskriminimi janë gur themeli edhe e të drejtës ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, të cilat janë ratifikuar nga vendi ynë, duke u bërë pjesë të rendit të brendshëm juridik, menjëherë pas Kushtetutës dhe me epërsi ndaj ligjeve kombëtare.

Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se liria e shprehjes, toleranca dhe respekti për dinjitetin e barabartë të të gjitha qenieve njerëzore është thelbësore për një shoqëri demokratike dhe pluraliste. Lufta kundër intolerancës dhe diskriminimit janë thelbësore në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, të drejta dhe liri që përbëjnë një nga bazat e shtetit. Dinjiteti i njeriut dhe të drejtat dhe liritë e tij, qëndrojnë në themel të shtetit tonë. Kushtetuta, sanksionon detyrimin e shtetit, jo vetëm të mos i cënojë ato, por të marrë masa dhe të ofrojë garancitë e duhura për të siguruar mos cënimin, për t'i mbrojtur dhe për të garantuar gëzimin e tyre nga të gjithë individët.

Liria e shprehjes, është një e drejtë Kushtetuese, e cila garantohet nga neni 22, pika 1, i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë⁶ ku parashikohet shprehimisht: *“Liria e shprehjes është e garantuar”*. Megjithatë, Komisioneri thekson sërish faktin se liria e shprehjes dhe mendimit nuk është një e drejtë e pakufizuar dhe se ajo nuk duhet të ushtrohet në një mënyrë të papajtueshme me të drejtat e të tjerëve.

Në bazë të nenit 17, Kushtetuta sanksionon se të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në të mund të kufizohen. Parashikimi i saj sqaron se: *“Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë. 2. Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.”* Në këtë kontekst, Kushtetuta e lidh kufizimin e të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara në të, me detyrimin për të mos tejkaluar kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ka përcaktuar sa më poshtë vijon në nenet respektive:

Në nenin 9, *“Liria e mendimit, e ndërgjegjes dhe e fesë”*, citohet se: *“1. Çdokush ka të drejtën e lirisë së mendimit, të ndërgjegjes e të fesë; kjo e drejtë nënkupton lirinë për të ndryshuar fenë ose besimin dhe lirinë, qoftë individualisht ose kolektivisht, publikisht ose privatisht nëpërmjet kultit, mësimdhënies, praktikave dhe kryerjes së riteve. 2. Liria e shfaqjes së fesë ose besimeve të dikujt nuk mund t'i nënshtrohet kufizimeve të tjera, përveç atyre të parashikuara nga ligji dhe që përbëjnë masa të nevojshme në një shoqëri demokratike në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, të shëndetit ose të moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të të tjerëve.”*

Në nenin 14, ku parashikohet *“Ndalimi i diskriminimit”*, citohet se: *“Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.”*

⁶ Neni 22 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë: *“Liria e shprehjes është e garantuar”*;

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr.27, Kodë Postar 1001, Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: info@kmd.al, web: www.kmd.al

Neni 17, “Ndalimi i shpërdorimit të të drejtave”: “Asnjë nga dispozitat e kësaj Konvente nuk mund të interpretohet se i jep një Shteti, grupimi ose individ, të drejtë që të përfshihet në ndonjë veprimtari ose të kryejë ndonjë akt që synon cënimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në këtë Konventë ose kufizime më të gjera të këtyre të drejtave ose lirive sesa është parashikuar në Konventë.”

Protokolli Nr. 12, në nenin 1 “Ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit”, citon: “1. Ky Protokoll do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit që pason mbarimin e një periudhe prej dy muajsh pas datës në të cilën shtatë Shtete anëtare të Këshillit të Evropës do të kenë shprehur pëlqimin e tyre për t’u lidhur me Protokollin, sipas dispozitave të nenit 8. 2. Askush nuk duhet të diskriminohet nga një autoritet publik për ndonjë nga arsyet e parashikuara në paragrafin 1.”

Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, referon në nenin 2 se: “1. Çdo shtet palë i këtij Pakti zotohet të respektojë dhe t’u sigurojë të gjithë njerëzve që ndodhen në territorin e tij dhe që varen nga juridiksioni i tij, të drejtat e njohura në këtë Pakt, pa kurrfarë dallimi të bazuar në racë, ngjyrë, seks, gjuhë, fe, opinion politik ose çdo opinion tjetër, origjinë kombëtare apo shoqërore, pasuri, lindje ose çdo gjendje tjetër.”

Në nenin 5, parashikohet se: “1. Asnjë dispozitë e këtij Pakti nuk mund të interpretohet asisoj sikur i njeh një shteti, një grupi ose një personi çfarëdo të drejte për të zhvilluar ndonjë veprimtari ose për të kryer një veprim që synon prishjen e të drejtave dhe lirive të njohura në këtë Pakt ose kufizimin e tyre në një shkallë më të gjerë se sa parashikohet me këtë Pakt...”

Neni 18, thekson: “1. Secili ka të drejtën e lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe fesë. Kjo e drejtë përfshin lirinë për të pasur ose për të adoptuar një fe ose një besim prej tij, si dhe lirinë për të manifestuar fenë apo besimin e vet, qoftë individualisht apo së bashku me të tjerët, si publikisht ashtu edhe privatisht, nëpërmjet kultit dhe kryerjes së riteve, praktikave dhe arsimit. 2. Askush nuk duhet t’i nënshtrohet ndonjë shtrëngimi që do të mund të prekte lirinë e tij për të pasur ose për të adoptuar një fe ose një besim të zgjedhur prej tij. 3. Liria e manifestimit të fesë apo të besimit të vet mund të bëhet objekt vetëm i kufizimeve të parapara me ligj dhe që janë të domosdoshme për mbrojtjen e sigurisë, të rendit e të shëndetit publik, ose të moralit apo të lirive dhe të drejtave themelore të të tjerëve. 4. Shtetet palë të këtij Pakti zotohen të respektojnë lirinë e prindërve dhe, kur është e zbatueshme, të kujdestarëve të ligjshëm për të siguruar edukimin fetar dhe moral të fëmijëve të tyre në përputhje me bindjet e tyre.”

Neni 19, parashikon: “1. Secili duhet të ketë të drejtën e opinionit pa ndonjë ndërhyrje. 2. Secili duhet të ketë të drejtën e lirisë së shprehjes; kjo e drejtë përfshin lirinë e kërkimit, marrjes dhe përhapjes së informacioneve dhe ideve të të gjitha llojeve, pavarësisht nga kufijtë, qoftë me gojë, me shkrim, në formë të shtypur ose artistike, ose me çdo mjet tjetër të zgjedhur prej tij. 3. Ushtrimi i lirive të parashikuara në paragrafin 2 të këtij neni, nënkupton detyra dhe përgjegjësi të posaçme. Për rrjedhojë ai mund t’u nënshtrohet disa kufizimeve të cilat duhet të përcaktohen shprehimisht me ligj dhe të jenë të domosdoshme: (a) Për respektimin e të drejtave ose të

reputacionit të tjerëve; (b) Për mbrojtjen e sigurisë kombëtare, të rendit publik, të shëndetit ose të moralit publik.”

Neni 20, parashikon: “1. Çdo propagandë në favor të luftës ndalohet me ligj. 2. Çdo thirrje për urrejtje kombëtare, racore ose fetare që përbën nxitjen për diskriminim, armiqësi dhe dhunë ndalohet me ligj.”

Ndërsa Neni 26, parashikon: “Të gjithë njerëzit janë të barabartë përpara ligjit dhe kanë të drejtë mbrojtjeje të barabartë të ligjit pa kurrfarë dallimi. Lidhur me këtë, ligji duhet të ndalojë çdo diskriminim dhe të garantojë për të gjithë, mbrojtje të barabartë dhe efektive, kundër çdo diskriminimi e sidomos për shkak të racës, ngjyrës, seksit, gjuhës, fesë, opinionit politik dhe çdo opinionit tjetër, origjinës kombëtare apo shoqërore, pasurisë, lindjes ose çdo situatë tjetër.”

Ligji Nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, përcakton:

Në nenin 1, se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Në nenin 3, parashikohen përkufizimet, duke parashikuar se:

1. “Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.

.....

8. “Gjuha e urrejtjes” është çdo formë e shprehjes në publik, me çdo mjet, e promovimit, nxitjes së denigrimit, urrejtjes ose shpifjes, çdo shqetësim, fyerje, stereotip negativ, stigmatizim ose kërcënim ndaj një personi ose grupi personash, si dhe çdo justifikim i të gjitha formave të shprehjes e bazuar në një listë joshteruese të shkaqeve, sipas nenit 1 të këtij ligji.”

Në nenin 7, të LMD-së, citohet se: “1. Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim.”

Akte dhe dokumenta të tjerë të Këshillit të Evropës dhe Kombeve të Bashkuara, parashtrihen si më poshtë:

- **Rekomandimi nr. R(97) 20 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare për “Gjuhën e urrejtjes” (miratuar nga Komiteti i Ministrave më 30 tetor 1997 në takimin e 607-të të Zëvendës Ministrave):**

Termi “gjuhë urrejtjeje” do të kuptohet si mbulim i të gjitha formave të shprehjes që përhapin, nxisin, ose justifikojnë urrejtjen racore, ksenofobinë, antisemitizmin ose forma të tjera urrejtjeje të bazuara në intolerancë, duke përfshirë: intolerancën e shprehur nga nacionalizmi agresiv dhe etnocentrizmi, diskriminimi dhe armiqësi kundër pakicave, emigrantëve dhe njerëzve me origjinë emigrante.”

- **Rekomandimi CM/Rek (2022)16, i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare për masat për luftën kundër gjuhës së urrejtjes (miratuar nga Komiteti i Ministrave më 20 Maj 2022 në sesionin e 132):**

Në vlerësimin e ashpërsisë së gjuhës së urrejtjes dhe përcaktimin e llojit të përgjegjësisë, nëse ka, duhet t'i atribuohet ndonjë shprehjeje specifike, autoritetet e shteteve anëtare dhe palët e tjera të interesuara, duke ndjekur udhëzimet e dhëna nga praktika gjyqësore përkatëse e Gjykatës, duhet të marrin të marrë parasysh faktorët e mëposhtëm dhe ndërveprimin ndërmjet tyre: përmbajtja e shprehjes; konteksti politik dhe social në kohën e shprehjes; qëllimi i folësit; roli dhe statusi i folësit në shoqëri; si shpërndahet apo përforcohet shprehja; aftësia e shprehjes për të çuar në pasoja të dëmshme, duke përfshirë afërsinë e pasojave të tilla; natyra dhe madhësia e audiencës dhe karakteristikat e grupit të synuar.

....

Organizatat e shoqërisë civile duhet të inkurajohen të krijojnë politika specifike për të parandaluar dhe luftuar gjuhën e urrejtjes dhe, kur është e përshtatshme dhe e mundshme, të ofrojnë trajnime për stafin, anëtarët dhe vullnetarët e tyre. Organizatat e shoqërisë civile duhet gjithashtu të inkurajohen që të bashkëpunojnë dhe të bashkërendojnë mes tyre dhe me palët e tjera të interesuara për çështjet e gjuhës së urrejtjes.”

Komisioni Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI), ka dalë me rekomadimet si më poshtë:

- **Rekomandimi Nr. 15 i Politikës Së Përgjithshme të ECRI-t “Për Luftimin e Gjuhës së Urrejtjes”, miratuar më 8 Dhjetor 2015:**

Duke pasur parasysh që, për qëllimet e këtij Rekomandimi të Politikës së përgjithshme, gjuha e urrejtjes duhet të kuptohet si avokim, promovim apo nxitje në çfarëdo formë të denigrimit, urrejtjes apo përgojimit të një personi apo grupe personash, si edhe si ngacmim, ofendim,

stereotipizim, stigmatizim apo kërcënim ndaj personit apo grupi personash dhe justifikimi i të gjitha llojeve të mëparshme të shprehjes mbi shkaqet e "racës"1 , ngjyrës, prejardhjes, përkatësisë kombëtare apo etnike, moshës, aftësisë së kufizuar, gjuhës, fesë apo besimit, seksit, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual dhe karakteristikave të tjera personale apo statusit;

....

Duke pranuar që udhëheqësit politikë, fetarë dhe komunitarë, si dhe personalitete të tjera të jetës publike, kanë një përgjegjësi veçanërisht të rëndësishme në këtë drejtim për shkak të aftësisë për të ndikuar te një publik i gjerë;

B. Përkufizime

Terminologjia

7. Për qëllimet e këtij Rekomandimi, zbatohen përkufizimet e m"avokim" lidhur me denigrimin, urrejtjen apo përgojimin nënkupton mbështetjen e shprehur, të qëllimshme dhe aktive për sjellje dhe qëndrime të tilla lidhur me një grup të caktuar personash;

- g. "denigrim" nënkupton sulmin ndaj kapacitetit, personalitetit apo reputacionit të një apo më shumë personave në lidhje me anëtarësimin e tyre në një grup të caktuar personash;
 - m. "urrejtje" nënkupton gjendjen mendore të karakterizuar nga emocione të forta dhe joracionale mllëfi, armiqësie dhe përçmimi ndaj grupit të shënjestruar.
 - q. "nxitje" nënkupton deklaratat për grupe personash të cilat krijojnë rrezik të menjëhershëm diskriminimi, armiqësie apo dhune ndaj personave të grupit/grupeve;
 - u. "stereotipizim negativ" nënkupton një opinion të përgjithshëm sikur një pjesëtar apo pjesëtarët e një grupi personash kanë karakteristika të caktuara, duke i vlerësuar me negativitet, pavarësisht karakteristikave të veçanta të pjesëtarit apo pjesëtarëve fjalë;
 - b. "stigmatizim" nënkupton etiketimin e një grupi personash në një mënyrë negative;
 - e. "përgojim" nënkupton kritikën abuzive ndaj një apo shumë personave lidhur me anëtarësinë e tyre në një grup të caktuar personash."
- **Rekomandimi (Rek) 1, i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës⁷, "Parandalimi/Luftimi i Seksizmit":**

Komiteti i Ministrave sipas Nenit 15.b të Statutit të Këshillit të Evropës:

Duke rikujtuar se barazia gjinore është thelbësore për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, funksionimin e demokracisë dhe qeverisjen e mirë, respektimin e sundimit të ligjit dhe promovimin e mirëqenies për të gjithë, që ngërthen në vete të drejta të barabarta për gratë dhe burrat, vajzat dhe djemtë, si dhe të njëjtin vizibilitet, fuqizim, përgjegjësi dhe pjesëmarrje në të gjitha sferat e jetës publike dhe private, dhe që nënkupton një qasje dhe ndarje të barabartë të burimeve midis grave dhe burrave, siç përcaktohet në Strategjinë e Këshillit të Evropës për Barazi Gjinore 2018 -2023;

⁷ Miratuar nga Komiteti i Ministrave më 27 korrik 2019 në takimin e 1342-të të zëvendësministrave.

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr.27, Kodi Postar 1001, Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: info@kmd.al, web: www.kmd.al

Duke rikujtuar se diskriminimi për shkak të seksit dhe/ose gjinisë përbën shkelje të të drejtave të njeriut dhe pengesë për realizimin e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, të njohura nga Komiteti i Kombeve të Bashkuara për eliminimin e diskriminimit ndaj grave në Rekomandimin e tij të Përgjithshëm Nr. 28 për detyrimet themelore të shteteve palë, në bazë të nenit 2 të Konventës për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave;

Duke rikujtuar se seksizmi është një tregues i marrëdhënieve historikisht të pabarabarta të pushtetit midis grave dhe burrave, gjë që rezulton në diskriminim dhe pengon përparimin e plotë të grave në shoqëri;

Duke vënë në pah se seksizmi është i përhapur dhe mbizotërues në të gjithë sektorët dhe të gjitha shoqëritë;

Duke pohuar se seksizmi përforcohet nga stereotipet gjinore që prekin gratë dhe burrat, vajzat dhe djemtë, dhe shkon kundër arritjes së barazisë gjinore dhe shoqërive gjithëpërfshirëse;

Duke theksuar se seksizmi përbën një pengesë për fuqizimin e grave dhe vajzave, të cilat preken në mënyrë disproporcionale nga sjellje seksiste; dhe më tej duke vënë në dukje se stereotipet gjinore dhe paragjykimet e qenësishme formësojnë normat, sjelljen dhe pritjet e burrave dhe djemve, dhe si rrjedhojë çojnë në akte seksiste;

Të shqetësuar se seksizmi është i lidhur me dhunën ndaj grave dhe vajzave, përmes të cilit aktet e seksizmit "të përditshëm" bëhen pjesë e një vazhdimësie të dhunës duke krijuar një klimë kërcënimi, frikësimi, diskriminimi, përjashtimi dhe pasigurie që kufizon mundësitë dhe lirinë;

Duke theksuar që gratë dhe vajzat mund të jenë subjekt i formave të shumta dhe të ndërthurura të diskriminimit dhe mund të përballen me seksizëm të kombinuar me norma ose sjellje të tjera që janë diskriminuese, urrejtëse ose të dëmshme;

Të vetëdijshëm se seksizmi dhe sjellja seksiste kryhen në nivele individuale, institucionale dhe strukturore, dhe përjetohen me efekte të dëmshme në të tri nivelet, masat për parandalimin dhe luftën kundër e seksizmit duhet të merren në të gjitha nivelet;

Duke rikujtuar Konventën e Kombeve të Bashkuara të vitit 1979 për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave (CEDAW), e cila kërkon që shtetet palë të ndërmarrin të gjitha masat e duhura *“për të modifikuar modelet shoqërore dhe kulturore të sjelljes së burrave dhe grave, me qëllim të arritjes së eliminimit të paragjyqimeve dhe të gjitha praktikave të tjera të zakonshme të cilat bazohen në idenë e inferioritetit ose epërsisë nga ndonjëra prej gjinive ose në role të stereotipizuara për burrat dhe gratë”*;

Duke patur parasysh objektivat e paraqitura në Deklaratën e Pekinit dhe Platformën për Veprim të miratuar nga Konferenca e katërt Botërore e Kombeve të Bashkuara për Gratë (1995), dhe

veçanërisht Raportin e Takimit Shqyrtues Rajonal në Pekin+20 për Evropë, të organizuar nga Komisioni Ekonomik i Kombeve të Bashkuara për Evropë në vitin 2014, i cili tregoi se *“stereotipet diskriminuese mbeten të përhapura dhe ndikojnë në edukimin dhe pjesëmarrjen e grave në ekonomi dhe në jetën publike”*;

Duke patur parasysh Rendin e punimeve të Kombeve të Bashkuara 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm, përfshirë Qëllimin e Zhvillimit të Qëndrueshëm 5 ("Arritja e barazisë gjinore dhe fuqizimit të të gjitha grave dhe vajzave"). Qëllimi i i Zhvillimit të Qëndrueshëm 16 ("Promovimi i shoqërive paqësore dhe gjithëpërfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, sigurimi i qasjes në drejtësi për të gjithë dhe krijimi i institucioneve efektive, të përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet") dhe Qëllimi i Zhvillimit të Qëndrueshëm 4 ("Sigurimi i arsimit gjithëpërfshirës, të barabartë e cilësor dhe promovimi mundësive për mësim gjatë gjithë jetës për të gjithë "), të cilat vlejnë për gjithë botën;

Duke patur parasysh Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve (1989) dhe ndalimin nga ana e saj të diskriminimit bazuar në gjininë e fëmijës ose të prindit të tij/saj ose të kujdestarit ligjor;

Duke rikujtuar Konventën për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (ETS Nr. 5) e cila ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave të njeriut;

Duke rikujtuar se lufta kundëri stereotipeve gjinore dhe seksizmit dhe sigurimi i integritetit të perspektivës së barazisë gjinore në të gjitha politikatat dhe masat janë objektiva prioritare në dokumentet dhe rekomandimet e Strategjisë së Këshillit të Evropës për Barazi Gjinore;

Duke rikujtuar se Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftën kundër e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (CETS Nr. 210, Konventa e Stambollit) kërkon që palët "të promovojnë ndryshime në modelet shoqërore dhe kulturore të sjelljes së grave dhe burrave me qëllim eliminimin e paragjyqimeve, zakoneve, traditave dhe të gjitha praktikave të tjera të cilat bazohen në idenë e inferioritetit të grave ose në role stereotipesh për gra dhe burra", dhe se Konventa e Stambollit gjithashtu kërkon që palët të kriminalizojnë ngacmimin dhe të marrin masat e nevojshme për të siguruar që ngacmimet seksuale iu nënshtrohen sanksioneve të duhura ligjore ose penale ;

Duke marrë parasysh Kartën Sociale Evropiane (ETS Nr. 35, ETS Nr. 163 [të rishikuar]) dhe dispozitat e saj për mundësi të barabarta, mos-diskriminim dhe për të drejtën e dinjitetit në punë;

Duke rikujtuar se Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut në praktikën e saj gjyqësore ka ritheksuar se avancimi i barazisë gjinore është sot qëllim kryesor në shtetet anëtare të Këshillit të Evropës dhe se referenca ndaj traditave, supozimeve të përgjithshme ose qëndrimeve mbizotëruese sociale janë justifikim i pamjaftueshëm për dallime në trajtime në baza gjinore. Për më tepër, Gjykata ka treguar që stereotipet gjinore, siç është perceptimi i grave si kryesoret për

t'u kujdesur për fëmijët dhe për burrat si mbajtës kryesor të familjes, nuk mund të justifikojnë vetvetiu një ndryshim në trajtim;

Duke rikujtuar rekomandimet e mëposhtme të Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare: CM/Rec (2007)13 për integrimin e dimensionit gjinor në arsim; KM/Rek (2007)17 për standardet dhe mekanizmat e barazisë gjinore; KM/Rek (2013)1 për barazinë gjinore dhe mediat; dhe KM/Rek (2017)9 për barazinë gjinore në sektorin audiovizual;

Duke iu referuar Rekomandimit të Politikës së Përgjithshme Nr.15 për luftën kundër gjuhës së urrejtjes, të miratuar nga Komisioni Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI) në dhjetor 2015, i cili përfshin gjuhën e urrejtjes seksiste;

Duke marrë parasysh Strategjinë e Këshillit të Evropës për të Drejtat e Fëmijëve (2016-2021), e cila thekson nevojën për të luftuar diskriminimin dhe dhunën, veçanërisht dhunën seksuale dhe nevojën për të promovuar barazinë midis vajzave dhe djemve, përfshirë adresimin e vazhdueshëm të stereotipeve, seksizmit dhe seksualizimit të tepruar, veçanërisht në media dhe arsim;

Duke marrë parasysh Strategjinë e Këshillit të Evropës për Kontroll të Internetit 2016-2019 dhe thirrjen e saj për veprim monitorimi për të mbrojtur të gjithë, në veçanti gratë dhe fëmijët, nga abuzimi në internet, përfshirë sulmet në internet, seksizmin dhe kërcënimet për dhunë seksuale;

Duke kujtuar Rezolutat 2119 (2016), 2144 (2017) dhe 2177 (2017) të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, përkatësisht për të "luftuar seksualizimin e tepruar të fëmijëve", "Ndalimin e diskriminimit kibernetik dhe urrejtjes në internet" dhe "Ndalimin dhunës seksuale dhe ngacmimit të grave në hapësirën publike";

Duke u bazuar në rezultatet e vënies në zbatim të instrumenteve dhe dokumenteve të lartpërmendura në nivele ndërkombëtare, kombëtare, rajonale dhe lokale, përfshirë arritjet dhe sfidat;

Të vetëdijshëm se me gjithë ekzistencën e standardeve në nivelin ndërkombëtar, kombëtar dhe rajonal që garantojnë parimin e barazisë gjinore, ende ekziston një hendek midis standardeve dhe praktikës, midis barazisë gjinore *de jure* dhe *de facto*;

Duke pranuar që mbizotërimi i shfaqjeve të ndryshme të seksizmit është i lidhur ngushtë me vështirësitë e vazhdueshme në arritjen e barazisë gjinore, me dëshirën për ta trajtuar seksizmin si çeshjtje kritike dhe pasojë e pabarazisë gjinore;

Duke theksuar mungesën e një përkufizimi të pranuar ndërkombëtarisht për "seksizmin" dhe të një instrumenti ligjor të përkushtuar për ta trajtuar atë;

Duke synuar krijimin e një Evrope të lirë nga seksizmi dhe shfaqjet e tij, Rekomandon që qeveritë e shteteve anëtare:

1. Të ndërmarrin masa për ta parandaluar dhe luftuar seksizmin dhe shfaqjet e tij në sferat publike dhe private dhe të inkurajojnë partnerët përkatës të zbatojnë legjislacionin, politikat dhe programet e duhura duke u bazuar në përkufizimin dhe udhëzimet e bashkëngjitura në këtë Rekomandim;
2. Të monitorojnë progresin në zbatimin e këtij Rekomandimi dhe të informojnë Komitetin(et) Drejtues kompetent(e) të Këshillit të Evropës për masat e ndërmarra dhe progresin e arritur në këtë fushë;
3. Të sigurojnë që ky Rekomandim, përfshirë shtojcën e tij, të përkthehet dhe t'iu shpërndalet (në formate të përdorshëm autoriteteve përkatëse dhe palëve të interesuara.

- **Shtojca e Rekomandimit KM/Rek (2019)1⁸, në mënyrë të detajuar ka shprehur se:**

Për qëllime të këtij Rekomandimi, seksizmi nënkupton:

- Çdo veprim, gjest, paraqitje vizuale, fjalë të thëna ose të shkruara, praktikë ose sjellje të bazuar në idenë se një person ose një grup personash është inferior për shkak të gjinisë së tyre, që ndodhë në sferën publike ose private, qoftë online apo offline, me qëllim ose efekt:

- i. të shkeljes së dinjitetit ose të drejtave thelbësore të një personi ose një grupi personash; ose
- ii. që rezulton me dëm fizik, seksual, psikologjik ose socio-ekonomik ose vuajtje për një person ose një grup personash; ose
- iii. të krijimit të një mjedisi frikësues, armiqësor, poshtëruës, ofendues ose fyes; ose
- iv. të krijimit të një pengese për autonominë dhe realizimin e plotë të të drejtave të njeriut nga një person ose një grup personash; ose
- v. ruajtjes apo forcimit të stereotipeve gjinore⁹.

- Konteksti i Rek (2019) 1

Nevoja për ta trajtuar seksizmin, normat dhe sjelljet seksiste dhe gjuhën seksiste është e nënkuptuar në një varg instrumentesh ndërkombëtare dhe rajonale.

Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe luftën kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (CETS Nr. 210, Konventa e Stambollit), ashtu si dhe Konventa e Kombeve të

⁸ 'Udhëzime për parandalimin dhe luftën kundër e seksizmit: masat për zbatim'.

⁹ "Stereotipet gjinore janë modele të vjetëruara sociale ose kulturore ose ide me anë të të cilave grave dhe burrave u caktohen karakteristika dhe role të përcaktuara dhe të kufizuara nga gjinia e tyre. Stereotipizimi gjinor paraqet pengesë serioze për arritjen e barazisë së njëmendtë gjinore dhe ushqehet nga diskriminimi gjinor. Stereotipizimet e tilla mund të kufizojë zhvillimin e talenteve dhe aftësive natyrore të vajzave dhe djemve, grave dhe burrave, preferencat dhe përvojat e tyre arsimore dhe profesionale, si dhe mundësitë e jetës në përgjithësi". (Strategjia e Këshillit të Evropës për Barazi Gjinore 2018-2023, Objektivi Strategjik 1)

Bashkuara për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW) njohin një vazhdimësi mes stereotipeve gjinore, pabarazisë gjinore, seksizmit dhe dhunës ndaj grave dhe vajzave.

Në këtë mënyrë, aktet e seksizmit "të përditshëm" në formën e sjelljeve, komenteve dhe shakave seksiste, në dukje të vogla dhe të padëmshme, janë ne skaj të kësaj vazhdimësie. Megjithatë, këto akte shpesh janë poshtëruese dhe kontribuojnë në një klimë sociale ku gratë përulen, vetëvlerësimi i tyre ulet dhe aktivitetet dhe zgjedhjet e tyre kufizohen, përfshirë në punë, në sferën private, publike ose në internet. Sjellja seksiste, e sidomos gjuha e urrejtjes seksiste, mund të përshkallëzohet ose të nxisë veprime të qarta fyese dhe kërcënuese, përfshirë abuzimin seksual ose dhunën, përdhunimin ose ndonjë veprim që mund të jetë vdekjeprurës. Pasoja të tjera mund të përfshijnë humbjen e burimeve të jetesës, vetë-dëmtimin ose vetëvrasjen. Prandaj trajtimi i seksizmit është pjesë e detyrimit pozitiv të shteteve për të garantuar të drejtat e njeriut, barazinë gjinore dhe për të parandaluar dhunën ndaj grave dhe vajzave në përputhje me legjislacionin ndërkombëtar të të drejtave të njeriut dhe për shtetet palë të Konventës së Stambollit.

Seksizmi dhe sjellja seksiste rezultojnë në dëmtime fizike, seksuale, psikologjike ose socio-ekonomike dhe ndikojnë në mënyra të ndryshme në sektorë të caktuar të popullatës. Gratë dhe vajzat preken në mënyrë disproporcionale nga sjellje të tilla. Seksizmi dhe sjellja seksiste përbëjnë pengesë për fuqizimin dhe përparimin e grave dhe vajzave; nga eliminimi i seksizmit dhe sjelljes seksiste do të përfitonin të gjithë: gratë, vajzat, burrat dhe djemtë.

Seksizmi dhe sjellja seksiste është e shprehur thuajse në të gjitha aktivitetet njerëzore, përfshirë hapësirën kibernetike (internet dhe media sociale). Ato mund të përjetohen individualisht ose kolektivisht nga një person ose një grup personash, edhe nëse as individi dhe as grupi nuk kanë qenë në shënjestër të drejtpërdrejtë, për shembull përmes reklamave seksiste, ose postimit të fotografive të grave lakuriq në vendin e punës. Të tri nivelet si përforcohet dhe përjetohet seksizmi janë: individuale, institucionale (për shembull familja, puna ose mjedisi arsimor), dhe strukturore (për shembull përmes pabarazive gjinore shoqërore, normave shoqërore dhe sjelljes). Seksizmi mbetet ne heshtje kur individët dhe grupet nuk e raportojnë atë ose nuk ankohen ndaj sjelljes seksiste nga frika se nuk merren seriozisht, se përjashtohen ose mbahen përgjegjës.

Interneti ka krijuar një dimension të ri për shprehjen dhe transmetimin e seksizmit, veçanërisht të gjuhës së urrejtjes seksiste, për një audiencë të madhe, edhe pse rrënjët e seksizmit nuk qëndrojnë në teknologji, por në pabarazi të vazhdueshme gjinore.

Seksizmi dhe sjellja seksiste janë të rrënjosura në stereotipe gjinore dhe i forcojnë ato. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut konsideron se *“çështja me stereotipizimin të një grupi të caktuar në shoqëri qëndron në faktin se ajo ndalon vlerësimin e individualizuar të kapaciteteve dhe nevojave të tyre.”*

- Ndërthurja, dobësitë e lidhura me situatën dhe rrethanat rënduese.

Gratë dhe burrat mund të ballafaqohen me forma të ndryshme dhe të ndërthurura të seksizmit, bazuar në një sërë faktorësh të tjerë duke përfshirë, mes tjerash, etninë, statusin e të qenit pakicë ose autokton, moshën, fenë, statusin e refugjatit ose emigrantit, aftësinë e kufizuar, statusin martesor, origjinën sociale, identitetin gjinor, orientimin seksual ose seksualitetin. Ata mund të ndodhen në situata më të rrezikuara ose të jenë në shënjestër të akteve të ndryshme të seksizmit në mjedise të ndryshme, si gratë e reja dhe gratë aktive në mjedise të dominuara nga meshkujt, për shembull në biznes, financa, ushtri ose politikë. Gratë në pozita të pushtetit ose autoritetit, përfshirë personalitetet publike, janë gjithashtu shënjestër e veçantë e seksizmit pasi ato perceptohen se kanë devijuar nga normat shoqërore të gjinisë që përjashtojnë gratë nga hapësirat publike ose autoriteti.

....

Seksizmi është veçanërisht i dëmshëm kur autori është në një pozitë të pushtetit, autoritetit ose ndikimit të tillë si politikan, opinionist ose drejtues biznesi. Një faktor tjetër rëndësues është aty ku shtrirja, ose arritja e mundshme, e gjuhës apo akteve seksiste është e gjerë, përfshirë mjetet e transmetimit, përdorimin e mediave sociale ose ato të transmetimit masiv dhe shkallën e përsëritjes.

- Mjetet dhe masat e përgjithshme për adresimin e seksizmit.

Qëllimi kryesor i masave për të parandaluar dhe luftuar seksizmin është të nxisë ndryshimin në sjellje dhe kulturë në nivele individuale, institucionale dhe strukturore.

Mjetet për ta parandaluar dhe luftuar seksizmin përveç planeve, politikave dhe programeve mund të përfshijnë dhe instrumente legjislative, ekzekutive, administrative, buxhetore dhe rregullatore. Shtetet duhet të zgjedhin mjetet më të përshtatshme me kontekstin e tyre si dhe objektivat e veprimeve të veçanta që duhet të ndërmerren. Mjete të ndryshme janë të nevojshme për të adresuar, në njërin anë, paragjykimin e pavetëdijshëm dhe, në anë tjetër, sjelljen e qëllimshme seksiste. E para mund të adresohet përmes rritjes së ndërgjegjësimit, trajnimit dhe edukimit, ndërsa masa më të forta janë të nevojshme për të eliminuar sjelljen e qëllimshme dhe të vazhdueshme seksiste dhe gjuhën e urrejtjes seksiste. Legjislacioni që adreson seksizmin, përfshirë përkufizimet; një udhëzues për përdorues; dhe një tregues i rrugëve të ndihmës dhe dëmshpërblimit për viktimat, dhe rreziqet dhe pasojat për autorët e krimit, janë opsione të rëndësishme për t'u marrë në konsideratë.

Shtetet duhet të përdorin mjetet ekzistuese dhe të sigurojnë zbatimin e tyre efektiv ose të vënë në dispozicion mjete të reja për ta parandaluar sjelljen seksiste dhe për t'u mbrojtur prej saj, kur është e përshtatshme, të ndjekin penalisht shkelësit dhe të sigurojnë dëmshpërblim për viktimat.

Qeveritë e shteteve anëtare janë ftuar të shqyrtojnë masat e mëposhtme për të mbështetur zbatimin e këtij Rekomandimi.

- Masat e ndërgjegjësimit.

Inkurajimin e reagimeve të shpejta nga figura publike, në veçanti politikanë, udhëheqës fetarë, ekonomikë dhe të komunitetit, dhe të tjerëve që janë në pozitë të formojnë opinionin publik, të dënojnë seksizmin dhe sjelljen seksiste dhe të forcojnë pozitivisht vlerat e barazisë gjinore.

.....

Promovimin e një perspektive për barazinë gjinore, si dhe zhvillimin e mendimit kritik për luftimin e seksizmit në përmbajtje, gjuhë dhe ilustrime të lodrave, në vizatime komike, libra, televizion, video dhe lojëra të tjera, informacione dhe filma në internet përfshirë pornografinë, të cilat formojnë qëndrimet, sjelljen dhe identitetin e vajzave dhe djemve.

Promovimin dhe zhvillimin e fushatave të rregullta të ndërgjegjësimit për ndërtimin e feminitetit dhe maskulinitetit dhe se çfarë do të thotë të jesh grua/vajzë ose burrë/djalë në shoqërinë bashkëkohore, për shembull, përmes mediave, ligjëratave dhe diskutimeve të lira publike.

Inkurajimin e bashkëpunimit mes të profesionistëve (për shembull gazetarëve, edukatorëve, kuadrit të organeve të rendit) dhe organizatave të shoqërisë civile për të përcaktuar dhe shkëmbyer praktikat e mira në parandalimin dhe luftimin e seksizmit.

Raporti i GREVIO-s për Shqipërinë, për masat legislative dhe të tjera që zbatojnë dispozitat e Konventës së Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (GREVIO/Inf(2017)13 Miratuar më 12 Tetor 2017¹⁰:

.....

GREVIO i përgëzon përpjekjet e autoriteteve për të promovuar ndërgjegjësimin për çështjet e dhunës ndaj grave. Më konkretisht, ai shpreh mirënjohjen e tij për nismat e ndërmarra nga autoritetet në këtë fushë, në lidhje me çështjet e barazisë gjinore dhe dhunës ndaj grave, dhe përfshirjen e burrave dhe djemve, si faktorë ndryshimi në luftën ndaj stereotipeve dhe eliminimin e të gjitha formave të dhunës.

Studimet e disponueshme për perceptimet rreth dhunës ndaj grave në Shqipëri¹¹ japin sugjerime të vlefshme, për sa i përket fushave ku mund të përqendrohen përpjekje të tilla. Këto përfshijnë, për shembull, qëndrimin që kanë si gratë, ashtu edhe burrat, që dënojnë disa forma të caktuara të dhunës, ose pranojnë dhunën në rrethana të caktuara (për shembull në rast provimi). Nismat për rritjen e ndërgjegjësimit duhet të sfidojnë bindjet e grave dhe vajzave, se gratë duhet ta tolerojnë dhunën për ta mbajtur familjen të bashkuar¹². GREVIO, në këtë drejtim, vë në dukje prirjen në Shqipëri për të nxitur faljen me pretekstin e ruajtjes së vlerave tradicionale familjare. Nisma të tilla duhet të synojnë më tej reformimin e roleve gjinore dhe stereotipeve të rrënjësura brenda familjes.

GREVIO¹³ mirëpret nismat e ndërmarra nga autoritetet, organizatat e shoqërisë civile dhe media për organizimin në partneritet të fushatave ndërgjegjësuëse për dhunën ndaj grave¹⁴. Megjithatë,

¹⁰ <https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2020/07/Raporti-GREVIO.pdf>

¹¹ Referojuni faqes 14 të raportit të Robin N. Haar (2013), Dhuna në Familje, në Shqipëri – Anketimi kombëtar i popullsisë

¹² 5 Referojuni faqes 33 të studimit të sipërpërmendur (Fjalë Burri)

¹³ Pjesëmarrja e sektorit privat dhe medias (neni 17)

GREVIO vëren interesin sporadik të medias lidhur me këto tema dhe prirjen e tyre për mbulim sensacional, të përmendur në raportin shtetëror, dhe mungesën e analizave të hollësishme të shkaqeve të dhunës ndaj grave që zënë fill nga gjinia¹⁵.

GREVIO mendon se mbulimi mediatik, i cili shpërfill të drejtat e viktimave, duke përfshirë edhe të drejtat e fëmijëve dëshmitarë të dhunës në familje, kanë prirjen ta zvogëlojnë rëndësinë e dhunës, dhe rrjedhimisht, ta fuqizojnë në vend që ta parandalojnë. Prandaj, GREVIO shpreh mbështetjen e tij kundrejt planit të autoriteteve për përmirësimin e kapaciteteve të profesionistëve të mediave rreth trajtimit të duhur të këtyre çështjeve, dhe nxitjes së tolerancës zero kundrejt dhunës ndaj grave¹⁶. Së fundi, kjo është një çështje e tillë që profesionistët e mediave duhet ta trajtojnë me përzemërsi, duke vendosur standarde vetërregullatore rreth mënyrës së duhur të shpërndarjes së informacionit për rastet e dhunës ndaj grave, krahas nxitjes dhe përforcimit të respektimit të dinjitetit të viktimës. Aktualisht, në Shqipëri, profesionistëve të mediave iu mungojnë këto standarde.

GREVIO i nxit autoritetet shqiptare të: a. vijojnë ta angazhojnë median si partner kyç në ndërgjegjësimin për dhunën ndaj grave; b. nxisin median, duke përfshirë edhe atë sociale, të vendosin dhe monitorojnë standardet në fushën e dhunës ndaj grave dhe barazisë gjinore, duke marrë në konsideratë standardet ekzistuese ndërkombëtare¹⁷.

Në lidhje me dhunën dhe abuzimin që përjetojnë vetë gazetarët, GREVIO ka dijeni për faktet e shpalosura, të cilat tregojnë nivele të larta të ngacmimeve dhe dhunës seksuale ndaj gazetarëve në shtetet anëtare të Këshillit të Evropës, duke përfshirë edhe Shqipërinë¹⁸. Për mundësimin e çlirimit të medias nga stereotipet dhe qasjet që lejojnë diskriminimin dhe dhunën ndaj grave, GREVIO e konsideron përmirësimin e pozicionit të grave në sektorin e medias, veçanërisht mbrojtjen e tyre nga çdo lloj dhune që i vendos në objektiv për shkak të faktit se janë gazetare, si

¹⁴ Referojuni pikës 5 “Media – kanali më i mirë për informimin rreth Konventës së Stambollit” të kontributit me shkrim të shoqatës së grave “Refleksione” në procesin e vlerësimit.

¹⁵ Referojuni edhe raportit kombëtar të Shqipërisë për zbatimin e Platformës së Pekinit “është e nevojshme të përqendrohemi te roli i medias në rikonceptimin e marrëdhënieve shoqërore midis burrave dhe grave, dhe në ndryshimin e qasjeve, pozicioneve dhe roleve tradicionale që përforcojnë stereotipet dhe pabarazinë gjinore. Është tejet e rëndësishme të kuptojmë se cilësia e raportimit aktual për të drejtat e njeriut, diskriminimin dhe barazinë gjinore, nuk ka të bëjë vetëm me të kuptuarin, i cili në vend që t’i japë fund stereotipeve, i përforcon ato, por edhe me kapacitetet teknike dhe qasjet mbizotëruese ekzistuese”.

¹⁶ Referojuni veprimtarive të pikës 3.1.7 të Planit Kombëtar të Veprimit të Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2016-2020

¹⁷ 6 Referojuni, ndër të tjera, dokumenteve të mëposhtme të Këshillit të Evropës: Rekomandimi Nr. R (84)17 i Këshillit të Ministrave të shteteve anëtare për barazinë ndërmjet grave dhe burrave në media; Rekomandimi 1555 (2002) nga Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës për imazhin e grave në reklamim; Rezoluta 1751 (2010) dhe Rekomandimi 1931 (2010) nga Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës për luftën ndaj stereotipeve seksiste në media. Referojuni edhe “Treguesve të ndjeshëm gjinorë për median” (GSIM) të UNESCO-s.

¹⁸ Referojuni, ndër të tjera, studimit të Këshillit Evropian: Gazetarët nën tryzni: Ndërhyrjet e pajustificueshme, frika dhe vetëcensurimi në Evropë, dhe studimit të Alana Barton-it dhe Hannah Storm-it Dhuna dhe ngacmimi ndaj grave në mediat e lajmeve: Një panoramë mbarë botërore, Fondacioni Ndërkombëtar i Grave në Media dhe Instituti Ndërkombëtar i Sigurisë së Lajmeve.

diçka tejet të rëndësishme. Për këtë arsye, GREVIO i tërheq vëmendjen autoriteteve për këtë fushë që përbën shqetësim, dhe për nevojën për ta bërë pikëpamjen gjinore pjesë të marrjes së masave të nevojshme për nxitjen e sigurisë së gazetarëve kundrejt çfarëdolloj ndërhyrjeje të pajustificueshme.

Motoja e Shqipërisë “tolerancë zero” kundër dhunës ndaj grave mbështetet në një sërë dispozitash ligjore, të cilat parashikojnë përgjegjësinë penale të autorëve të veprave në fushën penale. Pas parashikimit të një vepre penale të dedikuar për aktet e dhunës në familje¹⁹, të dhënata administrative mbi normat e raportimit të dhunës në familje janë rritur në mënyrë të vazhdueshme²⁰. Megjithatë, GREVIO është veçanërisht i shqetësuar për shtrirjen e të dhënave, gjë që tregon se një numër i vogël viktimash, më pak se 10%, kërkojnë ndihmë²¹. Andaj, pritet që tendenca e raportimit dhe normat e dënimit të jenë vazhdimisht në rritje, sepse gjithnjë e më shumë viktimat marrin guximin t'i drejtohen organeve ligj-zbatuese dhe gjykatave. Për format e tjera të dhunës ndaj grave, si dhuna seksuale, numri jashtëzakonisht i ulët i rasteve të regjistruara tregon se viktimat duhet ende të thyejnë tabutë e turpits dhe frikës. Pavarësisht se qasja holistike kundër dhunës ndaj grave nuk mund të mbështetet vetëm në sistemin e drejtësisë penale, gjykatat duhet të jenë në një linjë me qëndrimin e vendosur të ligjvënësit kundër dhunës dhe të ofrojnë një reagim të fuqishëm, duke përfshirë edhe ndëshkimet. Kjo do të nxiste raportimin e mëtejshëm.

Neni 36²² i Konventës së Stambollit kërkon që palët të kriminalizojnë të gjitha format e veprimeve kundër vullnetit të personit e që janë të një natyre seksuale, përfshirë përdhunimin. Përkufizimi i Konventës për dhunën seksuale ka si element kryesor mungesën e pëlqimit të dhënë lirisht me vullnetin e lirë të personit.

Neni 36 – Dhuna seksuale, përfshirë përdhunimin.

1. Palët marrin masat e nevojshme legjislative ose masa të tjera për të garantuar dënimin e sjelljeve të mëposhtme të qëllimshme: a) përfshirja në depërtim të detyruar vaginal, anal ose oral të një natyre seksuale, në trupin e një personi tjetër me pjesë trupore ose objekte; b) përfshirja me një person në akte të tjera të detyruara të një natyre seksuale; c) nxitja që

¹⁹ Shiko Ligjin Nr. 23 / 2012 që kriminalizon dhunën në familje

²⁰ Shiko Raportin "Hijet", fusha e kujdesit shëndetësor, rasti i Shqipërisë ", të paraqitur pranë Komitetit CEDAW nga Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin (QSHPZH), 2016, faqe 39: "Ka një rritje progresive, nga viti në vit, të numrit të personave që kallëzojnë dhunën dhe krime të tjera që ndodhin në ambientet familjare. Nga 94 raste të regjistruara në vitin 2005, vetëm për periudhën janar-shtator 2015, ky numër shkon rreth 3,000 raste. Ka një rritje domethënëse në identifikimin e këtyre rasteve, veçanërisht pas ndryshimeve në Kodin Penal, në vitin 2012 dhe 2013, ku dhuna në familje konsiderohet si krim dhe dënohet si çdo krim tjetër. Në vitin 2014, pati një rritje me rreth 30% të rasteve të regjistruara dhe një rritje me më shumë se 35% të numrit të ankesave dhe padive të depozituara për lëshimin e urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes".

²¹ Shiko faqen 55 të raportit të Robin N. Haar (2013), Dhuna në familje në Shqipëri, Anketim kombëtar me bazë popullore: "Gratë e rrahura shpesh hezitojnë të kërkojnë ndihmë për dhunën në familje. Në fakt, (...) vetëm 8.4% e grave që "kanë përjetuar ndonjëherë" dhunë në familje dhe 7.1% e grave që "aktualisht" përjetojnë dhunë në familje përpigën të kërkojnë ndihmë për dhunën në martesat e tyre/marrëdhëniet intime. Kjo gjetje tregon se shumica e grave të dhunuara në Shqipëri vazhdojnë të vuajnë në heshtje (...)"

²² Dhuna seksuale, përfshirë përdhunimin.

- një person tjetër të përfshihet me një person të tretë në akte të detyruara të një natyre seksuale.
2. Pëlqimi duhet të jepet vullnetarisht si rezultat i vullnetit të lirë të personit të vlerësuar në kontekstin e rrethanave më të afërta.
 3. Palët marrin masat e nevojshme legjislative ose masa të tjera për të garantuar që dispozitat e paragrafit 1 të zbatohen edhe për aktet e kryera kundër ish bashkëshortëve/partnerëve ose bashkëshortëve/partnerëve aktualë, të njohur nga ligji i brendshëm.

GREVIO u kërkon autoriteteve:

- a. të ndryshojnë përkufizimin e përdhunimit të grave të rritura në mënyrë që ky përkufizim të bazohet në mungesën e pëlqimit të dhënë lirisht dhe që nuk kërkon demonstrim e përdorimit të forcës apo rezistencës;
 - b. të ndryshojnë përkufizimin e përdhunimit me të mitur të moshës 14 - 18 vjeç në mënyrë që ky përkufizim të bazohet në mungesën e pëlqimit të dhënë lirisht dhe të mos kërkojë demonstrimin e përdorimit të forcës apo rezistencës.
- Për vlerësimin e pëlqimit të plotë e të lirë të fëmijës, duhet t'i kushtohet rëndësi hendekut të moshës ndërmjet dhunuesit dhe viktimës;
- c. të ndryshojnë përkufizimin e përdhunimit me të mitur të moshës 14 - 18 vjeç, në mënyrë që ai të mos varet nëse viktimat ka arritur moshën e pjekurisë apo jo;
 - d. të kriminalizojnë sjelljen seksuale pa pëlqimin e personit që përkrahur Neni 36, pika 1, shkronjat b dhe c të Konventës;
 - e. të miratojnë masat e nevojshme për të garantuar që dispozitat e njohura nga drejta ndërkombëtare të zbatohen për çdo vepër penale të dhunës seksuale ndërmjet ishbashkëshortëve/partnerëve apo bashkëshortëve/partnerëve aktualë.

Progres Raporti i Komisionit Europian për Shqipërinë 2021, publikuar në 19 tetor 2021, mes të tjerash, në nënpikën Barazia gjinore²³, vë në dukje se:

Dhuna me bazë gjinore është po ashtu një çështje e cila merr vëmendje në raport, duke pasur parasysh numrin e lartë të rasteve të dhunës me bazë gjinore në familjet shqiptare.

“Gjatë periudhës janar-dhjetor 2020, u identifikuan dhe u përpunuan 4.701 raste të dhunës në familje. Midis këtyre, 1.505 raste janë referuar në Prokurori, 535 autorë janë arrestuar. Në vitin 2020, pati shtatë vrasje në marrëdhëniet familjare, gjashtë nga shtatë ishin gra”, - thuhet në raport. Raporti thekson se duhet të ofrohen shërbime të specializuara dhe të riintegritimit për viktimat dhe puna në menaxhimin e rasteve duhet të forcohet edhe më tej.

Raporti i ECRI-t për Shqipërinë (cikli i gjashtë monitorues), miratuar më 7 prill 2020²⁴:

²³ Faqe 33, e Progres Raportit; <https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2021-10/Albania-Report-2021.pdf>

²⁴ Faqe 17 e Raportit, në variantin e gjuhës shqipe.

ECRI rekomandon që autoritetet të marrin frymëzim nga rekomandimi i Politikave të Përgjithshme Nr.15 i ECRI-t për luftën kundër gjuhës së urrejtjes dhe të dënojnë me forcë dhe publikisht incidente të gjuhës së urrejtjes. Ata gjithashtu duhet të inkurajojnë figura të tjera publike të dënojnë veprime të tilla dhe të përfshihen në kundërpërgjigje.

Raporti i Komisionit Evropian, për Shqipërinë, publikuar më datë 31.05.2023²⁵:

Në vitin 2021, policia evidentoi dhe trajtoi 5.312 raste të dhunës dhe krimeve të tjera të kryera në marrëdhëniet familjare, duke u vërejtur një rritje prej 13% krahasuar me vitin 2020. Ndër to, 3.266 raste të dhunës në familje janë trajtuar me kërkesë për urdhër mbrojtje dhe 1.630 raste janë referuar në prokurori. Në të dyja rastet, u regjistrua një rritje e lehtë ndaj shifrave të vitit 2020. Për rrjedhojë, 638 autorë të dhunës në familje u arrestuan dhe 123 u ndaluan. Dhuna në familje u rrit gjatë periudhës së bllokimit Covid-19.

Tetëmbëdhjetë gra dhe vajza u vranë brenda marrëdhënieve familjare në vitin 2021, krahasuar me gjashtë të raportuara në vitin e kaluar. Nevojiten më shumë përpjekje për ta ndryshuar këtë prirje, duke përfshirë zbatimin më të mirë të ligjit, mesazhet institucionale për t'i dhënë fund dhunës ndaj grave dhe duke rritur ndërgjegjësimin e grave për të drejtat e tyre dhe shërbimet e disponueshme.

Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030, miratuar me VKM nr. 400, datë 30.06.2021 *“Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030, dhe të Planit të saj të Veprimit”*:

E konceptuar si vijim dhe e lidhur logjikisht me Strategjinë e mëparshme për Barazinë Gjinore 2016-2020²⁶, “SKBGJ 2021-2030” përbën një udhërrëfyes drejt një shoqërie ku të gjithë individëve gra, burra, të reja, të rinj, vajza e djem, pavarësisht moshës, gjinisë, vendlindjes e vendbanimit, grupit etnik apo social, aftësive të kufizuara, përkatësisë e besimit fetar, shprehjes së identitetit gjinor e orientimit seksual, si dhe karakteristikave të tjera individuale, u jepen mundësi të barabarta të zhvillojnë potencialet e tyre; të marrin pjesë në mënyrë të barabartë në vendimmarrjen politike e publike; të zgjedhin e të zgjidhen; të edukohen dhe aftësohen gjatë gjithë jetës; të punësohen e punësojnë duke avancuar drejt profesioneve të reja e duke sfiduar stereotipet dhe ndarjen gjinore të punës; të ndikojnë në zhvillimin socio-ekonomik të vendit dhe të mbështeten për t’u zhvilluar në aspektin social dhe ekonomik; të krijojnë familje të shëndetshme, ku prindërit ndajnë përgjegjësitë në mënyrë të barabartë dhe ku komunikimi është çelësi i zgjidhjes së problemeve; të jetojnë të lirë nga praktiket e dëmshme dhe dhuna; si dhe ku grupet e cënueshme trajtohen me përparësi dhe mbështeten derisa të fuqizohen e gëzojnë të drejta dhe mundësi të barabarta në të gjitha fushat e jetës - pra një shoqëri ku barazia nuk ngatërrohet me njëtrajtshmërinë dhe ku askush nuk duhet të mbetet pas.

²⁵ Faqe 13 e Raportit, përkthim i Komisionerit: <https://www.dap.gov.al/publikime/dokumenta-strategjik/63-progres-raportet>

²⁶ <https://www.un.org.al/sites/default/files/SKGBJ-AL-web.pdf>

“SKBGJ 2021-2030” është e katërta e këtij lloji dhe padyshim reflekton (sikurse dhe strategjitë e mëparshme), përparësinë dhe vëmendjen e veçantë që Qeveria e Shqipërisë i kushton arritjes së barazisë gjinore, si dhe zvogëlimit të dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje, duke e konsideruar adresimin e duhur të tyre si kushte drejt një zhvillimi të qëndrueshëm.

Në të gjithë dokumentin strategjik dhe planin e veprimit të SKBGJ 2021 – 2030, theksohet rëndësia e mbështetjes, trajtimit dhe fuqizimit të grave, të rejave dhe vajzave në tërësi, përfshirë edhe nga grupe të cënueshme e që pësojnë diskriminim të shumëfishtë si: gra, të reja dhe vajza nga zonat rurale, nga minoritetet etnike, me aftësi të kufizuara, LGBTI+, nëna të vetme, të dhunuara, të trafikuar, të moshuara, azilkërkuese, etj, pra nga të gjitha grupet në shoqëri.

Një nga qëllimet strategjike të këtij dokumenti është edhe zvogëlimi i të gjitha formave të praktikave të dëmshme, dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, duke parashikuar:

Edhe për përmbushjen e këtij qëllimi strategjik janë parashikuar objektiva specifike të bazuar në SKBGJ 2016-2020 duke shtuar dhe theksuar domosdoshmërinë e ndëshkimit dhe rehabilitimit të dhunuesve, shtimin e shërbimeve mbështetëse të specializuara për mbështetjen e të mbijetuarave deri në riintegrimin e tyre, ndërgjegjësimin e shoqërisë për të mos e toleruar dhunën ndaj grave e dhunën në familje, etj.

Ndër treguesit e impaktit në këtë qëllim strategjik është:

- Përqindja e grave, të rejave dhe vajzave të moshës 15+ nështruar dhunës fizike, seksuale ose psikologjike nga partneri aktual ose ish-partneri intim të 12 muajve të mëparshëm.

IV. Analiza ligjore e fakteve dhe provave.

Rezulton se, më datë 14.04.2023, në televizionin kombëtar Top Channel, është transmetuar emisioni “Më lër të flas”, me tematikë diskutimi tradhëtinë, emision i zhvilluar në formën e bisedës, diskutimit dhe shprehjes së opinioneve e mendimeve mes të ftuarve. Një ndër të ftuarit në këtë emision dhe pjesëmarrës në diskutime ka qenë edhe av. S. N.

Nga subjekti ankues, është pretenduar se gjatë bisedës së zhvilluar dhe shprehjes së mendimeve nga ana e z. N është përdorur një gjuhë jo e përshtatshme dhe e asaj natyre që ka nxitur një reagim në publikun që e ndjek, gjuhë të cilën ata e konsiderojnë “gjuhë urrejtjeje”.

Pikërisht përse më lart, subjekti ankues, Shoqata “Për Drejtësi Sociale”²⁷, ka paraqitur ankesë kundër S. N, dhe emisionit “Më lër të flas” në televizionin Top Channel, në të cilën pretendohet për diskriminim në formën e “gjuhës së urrejtjes”, për shkak të gjinisë.

²⁷ Në vijim referuara edhe si Shoqata.

Sipas informacionit të dhënë nga subjekti ankues, Shoqata, në emisionin “Më lër të flas” të datës 14.04.2023, të transmetuar në televizionin Top Channel, i cili kishte si tematikë diskutimi tradhëtinë është zhvilluar dialogu i mëposhtëm:

“

S. N: - Sipas legjislacionit anglez, nuk mund ta akuzosh ti tjetrin për përdhunim në rast se nuk ke rezistuar.

Prezantuesi 1: Duhet t’i kërkosh leje a mund të të përdhunoj?

Prezantuesi 2: Me mesazh do të përdhunoj sot nga ora 4.

S. N: Eshtë dhe scherzo e vajzës që bën sikur jo. Të akuzojnë X për përdhunim, në bazë të së drejtës penale angleze, ata matin sa e ke segmentin e rezistencës. Sepse vjen një moment i caktuar që femra...pasi femra është shtrënguar për përdhunim, dorëzohet nga kënaqësia. Prandaj duhet të jetë e lartë rezistenca që të dënohet....

...gratë janë natyra më të dobëta, ata nuk rezistojnë dot, madje ndjejnë kënaqësi dhe në momentin që përdhunohen dhe më pas dorëzohen.”

Për sa më sipër, Shoqata konsideron se në dialogun e transkriptuar më lart, është përdorur gjuhë urrejtjeje dhe denigruese e cila prek në mënyrë të drejtëpërdrejtë gratë, duke u shprehur se:

“Pyetjet dhe shprehjet e përdorura tregojnë seksizëm ku theksohet një dallim gjinor pa bazë shkencore dhe nxitet dhuna ndaj njëres gjini.... duke nënkuptuar se nëse shtrëngohen sa duhet femrat do të kenë kënaqësi gjatë përdhunimit, duke dizinformuar kështu publikun për ligjin anglez për dhunën seksuale, duke e deformuar totalisht atë.”

Lidhur me disponimin e videos së emisionit apo linkut zyrtar të Tv. Top Channel, Komisioneri ka kërkuar nga Top Channel që një kopje e tij, t’i vihet në dispozicion, në funksion të procesit hetimor të ankesës në fjalë.

Top Channel, si autoriteti që mban autorësinë e sa më sipër, nëpërmjet shkresës me nr. 357/1 prot., datë 05.05.2023 ka vendosur në dispozicion të KMD-së, linkun e emisionit “Më lër të flas”, të datës 14.04.2023:

<https://m.youtube.com/watch?v=3bsUu6WYRyU&pp=ygUdTWUgbGVyIHRIIGZsYXMgc3Bhc nRhayBuZ2plbGE%3D>²⁸

Në rastin konkret, institucioni i Komisionerit ka zbatuar detyrimet ligjore të parashikuara jo vetëm në ligjin e tij rregullator, por dhe detyrimet e parashikuara në ligjin nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, pavarësisht se, referuar nenit 78²⁹, të tij, materiale të tilla, lejohen të riprodhohen pa autorizimin e autorit ose të titullarit të së drejtës së

²⁸ “ Sonte në “Më lër të flas”, si temë të parë kemi tradhëtinë. Ka ndodhur. A duhet ta tregosh dhe të rrezikosh të ndahesh, apo ta mbash për vete? A është heshija më e rëndë se vetë akti? Për këtë dhe shumë të tjera do të diskutojmë me super panelin e sotëm... Të ftuar: -Zh. L -Sh. L -S. N -A. P”

²⁹ “Përdorimi i veprave për procedura gjyqësore, administrative dhe procedura të tjera zyrtare” parashikon se: “Veprat me të drejtë autori do të lejohen të riprodhohen dhe të përcillen për publikun, për rastet konkrete, pa autorizimin e autorit ose të titullarit të së drejtës së autorit dhe pa shpërblim, për kryerjen e detyrave që lidhen me sigurinë publike, për përdorimin dhe kryerjen e procedurave gjyqësore, administrative, parlamentare dhe procedurave në arbitrazh, përveçse në rastin e përmbledhjeve”.

autorit dhe pa shpërblim, për kryerjen e detyrave që lidhen për përdorimin dhe kryerjen e procedurave gjyqësore, administrative.

A. Lidhur me pretendimin e subjektit ankues, Shoqatës, për diskriminim nga ana e Televizionit Top Channel, përsa i takon mosveprimet të tyre në kuadër të distancimit nga gjuha e përdorur në emisionin “Më lër të flas”, nga i ftuari av. N.

Sa i përket pretendimeve të Shoqatës, lidhur me faktin se nga ana e drejtuesve të emisionit në fjalë nuk është mbajtur qëndrimi i duhur kundrejt shprehjeve e gjuhës së përdorur nga njëri prej të ftuarve të tyre, av. N, Komisioneri vëren se, gjatë procesit të shqyrtimit të këtij rasti, në kronologjinë e ngjarjeve e veprimeve të ndërmarra, nga subjekti kundrejt orientohet ky pretendim, evidentohet se:

- Fillimisht në përgjigjen e kthyer Komisionerit, Top Channel është shprehur se si nga ana e drejtuesve të emisionit, (po ashtu edhe të ftuarve të tjerë të pranishëm në emision) si nga ana e televizionit është mbajtur qëndrim i qartë dhe veprime që shprehin distancimin e tyre nga gjuha, shprehjet e papërshtatshme të përdorur gjatë emisionit nga i ftuari av. N.
- I njëjti qëndrim është mbajtur nga përfaqësuesit ligjorë të televizionit edhe gjatë seancës dëgjimore, ku u theksua fakti se drejtuesit e emisionit që gjatë emisionit janë distancuar nga shprehjet e përdorura nga i ftuari av. N dhe se në vijim si masë tjetër ishte që z. N të mos jetë më i pranishëm në emision në asnjë prej puntatave në vazhdim.
- Nga subjekti ankues, gjatë seancës dëgjimore, u dakordësua se, në rastin në fjalë përsa i takon veprimeve të ndërmarra nga ana e televizionit Top Channel, ata do ta konsiderojnë të zgjidhur problematikën e paraqitur pranë KMD-së, nëse nga ana e tyre do të merren masa për heqjen nga You Tube, të pjesës ku z. N zhvillon dialogun e kontestuar prej tyre³⁰, si dhe të parashikohet një dokument ku të ftuarit të nënshkruajnë paraprakisht, para pjesëmarrjes në emisione të tilla, se do të respektojnë legjislacionin për mbrojtjen nga diskriminimi, dhe se nuk do të përdorin gjuhë urretjeje.
- Nëpërmjet e-mailit të datës 26.07.2023, përfaqësuesja e Top Channel ka depozituar pranë KMD-së një kopje të përditësuar të Deklaratës Tip, për të ftuarit në emisione të ndryshme të Top Channel, dhe sipas orientimit të KMD-së gjatë seancës dëgjimore, në pikën 12 të saj, parashikohet se: “ *Deklaroj se nuk do të përdor gjuhë urretjeje dhe diskriminuese, si dhe do të mbaj përgjegjësi për deklaratat e mija ndaj çdo pretendimi nga palët e treta.* ”
- Po ashtu, lidhur me kërkesën e linkut të emisionit “Më lër të flas”, të datës 14.04.2023, Top Channel ka disponuar informacionin se ky link është bërë privat dhe janë hequr sekuencat ku Av. N shprehet për përdhunimin, si më lart cituar.

³⁰ Referohu tek fq.29, e vendimit.

- Informacioni dhe dokumentacioni bashkëlidhur, i është dërguar për njohje, nëpërmjet e-mailit subjektit ankues, Shoqatës.

Komisioneri vlerëson se, nga ana e Televizionit është mbajtur qëndrim kritik kundrejt gjuhës së përdorur nga i ftuari av. N, duke u distancuar nga opinionet e shprehura prej tij, si dhe duke marrë masat konkrete për në vazhdim, lidhur me veprimtari të ngjashme të këtij televizioni.

Komisioneri sjell në vëmendje faktin që përgjegjësia e televizioneve të tilla, si Top Channel, është akoma më e madhe për shkak se janë televizione mbarëkombëtare, me transmetim në gjithë territorin e Shqipërisë, si dhe për shkak të shikueshmërisë së madhe që kanë, apo ndikimit në publikun e gjerë që e ndjek (përfshirë edhe fashën e orarit kur ai transmetohet).

Për rrjedhojë, edhe ndikimi që ata kanë është i madh tek publiku që i drejtohet, dhe për këtë arsye, si dhe për faktin që ndër të tjera, ata kanë karakter informues e edukues, kujdesi për gjuhën e përdorur duhet të jetë i shtuar dhe i përhershëm.

“Megjithëse media mund të mos jetë përgjegjëse për veprimet, qëndrimet ose sjelljet e individëve, ajo është pa diskutim e plotfuqishme në formimin e opinionit publik, theksimin e çështjeve apo perspektivave që mund të jenë objekt i debateve publike. Media gjithashtu mund të jetë një mjet shumë i fuqishëm për promovimin e barazisë gjinore në shoqëri.

Këshilli i Europës në Rekomandimet për Barazinë midis Burrave dhe Grave në Media (nr. R84-17) nënvizon se “media luan një rol të rëndësishëm në formimin e qëndrimeve dhe vlerave sociale dhe gjithashtu ofron një potencial shumë të madh si instrument të ndryshimeve sociale”. Kombet e Bashkuara që prej vitit 1995 (me Platformën e Pekinit), kanë identifikuar ‘median dhe përkatësinë gjinore’ si një nga çështjet më kritike që lidhen drejtpërdrejt me barazinë gjinore.”³¹

Referuar sa më lart, Komisioneri vëren se, në parim, pavarësisht faktit se, Televizioni mund të mos jetë përgjegjës për shprehjet e përdorura nga të ftuarit në emisione të ndryshme, ai mban përgjegjësi për shpërndarjen e tyre, nëpërmjet kanaleve të ndryshme të informimit si: ritransmetimet, you tube, facebook, instagram, tik-tok, etj. Në këtë këndvështrim, Televizioni, mban përgjegjësi dhe duhet të tregohet tejet i kujdesshëm që të mos shpërndajë përmbajtje të materialit, i cili në vetvete mund të përbëjë gjuhë urrejtje.

Mbështetur në sa më sipër, e referuar rastit konkret, Komisioneri vlerëson se, masat e ndërmarra nga Televizioni Top Channel, pas ndërmjetësimit të Komisionerit, bazuar edhe në kërkesën e subjektit ankues, *së pari*, konsiderohen si veprimet e duhura dhe masa efektive të ndërmarra prej tyre, lidhur jo vetëm referuar emisionit në fjalë, por edhe në parim për të gjitha emisionet që do të pasojnë në vijim, dhe *së dyti*, kënaqin kërkesat e subjektit ankues, që rasti në fjalë të konsiderohet i zgjidhur efektivisht.

³¹ Dokumenti “Dhuna në familje në fokusin e medias”. Botimi i kësaj guide është mbështetur financiarisht nga Zyra e Marrëdhënieve me Publikun e Ambasadës së SH.B.A.-së në Tiranë, në kuadrin e projektit “Mjete praktike për raportimin në media të dhunës në familje”.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se qëllimi për të cilin ishte filluar hetimi administrativ është përmbushur në thelb, dhe në referencë të nenit 33, pika 9, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se:

“Kur e sheh të përshtatshme, Komisioneri kërkon të arrijë marrëveshje pajtimi mes ankuesit dhe personit kundër së cilit është paraqitur ankesa”, KMD vlerëson se është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin ishte iniciuar ankesa, lidhur me pretendimin për diskriminimin kundrejt Televizionit Top Channel.

Në nenin 90/3 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” parashikohet përfundimi i procedurës administrative:

“Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ.”

Njëkohësisht, në referencë të nenit 94/1, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon se:

“Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë”, Komisioneri deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar.

B. Lidhur me shprehjet dhe gjuhën e përdorur nga av. S. N.

Në mediat shqiptare, jo në pak raste, është konstatuar se kultura e fjalës së përdorur nuk është e duhura. Njëkohësisht, është vënë re jo në pak raste jemi ndeshur me fenomenin e nxitjes, përdorimit dhe përhapjes së “gjuhës së urrejtjes” në publik për kategori apo grupe shoqërore, pa reflektuar asnjë ndjenjë përgjegjësie për fjalën e thënë në mediane dhe shkruar dhe atë televizive.

Liria e shprehjes buron nga parashikimet përkatëse në aktet juridike ndërkombëtare dhe standardet minimale të saj rezultojnë të përcaktuara në aktet ndërkombëtare të detyrueshme në nivel të përgjithshëm ndërkombëtar dhe në nivel rajonal. Shtetet palë e kanë për detyrë t’i inkorporojnë të drejtat dhe liritë në legjislacionin vendas dhe, në rast të cenimit të tyre, të mundësojnë mjete juridike për të rivendosur të drejtat e shkeluara.

Duke mbajtur parasysh, hierarkinë e normave juridike të sanksionuara në nenin 116 të Kushtetutës, i cili sanksionon epërsinë e të drejtës ndërkombëtare të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë mbi ligjet e brendshme, Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, në referim edhe të evokimit që i bëhet asaj në nenin 17/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, merr një status kushtetues në të drejtën tonë të brendshme.

Për rrjedhojë logjike edhe praktika e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ), me anë të të cilave bëhet interpretimi i Konventës, ka fuqinë e Konventës.

KEDNJ është forma më e rëndësishme e shprehjes së angazhimit të shteteve anëtare të Këshillit të Evropës për vlerat e demokracisë, paqes dhe drejtësisë dhe nëpërmjet tyre, për respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të individëve që jetojnë në këto shoqëri. Kjo Konventë përmban parashikime të rëndësishme mbi lirinë e shprehjes, ku përveç mbrojtjes që i siguron kësaj të drejte, përcakton edhe kufizimet përkatëse.

Për sa më sipër, në Nenin 10, të KEDNJ-së parashikohet shprehimisht:

“1. Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë. Ky nen nuk i ndalon Shtetet që të kërkojnë liçencimin e ndërmarrjeve të transmetimit kinematografike ose televizive.

2. Ushtrimi i këtyre lirive që përmban detyrime dhe përgjegjësi, mund t’u nënshtrohet atyre formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare, integritetit territorial ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose të të drejtave të të tjerëve, për të ndaluar përhapjen e të dhënave konfidenciale ose për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor.”

Në paragrafin e parë të këtij neni përkufizohen të drejtat e mbrojtura, ndërkohë që në paragrafin e dytë të tij, përcaktohen rrethanat në të cilat një shtet në mënyrë të legjitimuar mund të ndërhyjë tek ushtrimi i lirisë së shprehjes. Për më tepër, neni 10 i KEDNJ-së, mbron jo vetëm përmbajtjen e informacionit dhe ideve, por edhe formën në të cilën janë shprehur ato. Kështu, dokumentet e shkruara, transmetimet në radio dhe televizione, pikturat, filmat, apo edhe sistemet e informacionit elektronik janë gjithashtu të mbrojtura sipas këtij neni. Për pasojë, mjetet e prodhimit dhe komunikimit, transmetimit ose shpërndarjes së informacionit dhe ideve mbulohen gjithashtu nga neni 10, i KEDNJ dhe institucionet për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe gjykatat duhet të jenë të ndërgjegjshëm për zhvillimet e shpejta teknologjike dhe mënyrës së si liria e shprehjes mund të ndahet nëpërmjet mënyrave të tilla.

Mbështetur në paragrafin 2, të nenit 10 të KEDNJ-së, autoritetet vendase në çdonjërin nga Shtetet Kontraktues mund të ndërhyjnë me ushtrimin e lirisë së shprehjes, kur plotësohen 3 (tre) kushte së bashku³²:

1. Ndërhyrja (në kuptimin e “formalitetit”, “kushtit” ose “sanksionit”) parashikohet me ligj;
2. Ndërhyrja ka si qëllim të mbrojtë një ose më shumë nga interesat ose vlerat e mëposhtme: sigurimin kombëtar; integritetin territorial; sigurinë publike; ndalimin e krimit dhe mbrojtjen e rendit; mbrojtjen e shëndetit; moralit; reputacionin ose të drejtat e të tjerëve; ndalimin e zbulimit

³² Carss-Frisk, M., Një udhëzues për zbatimin e Nenit 10 të Konventës Evropiane - Liria e Shprehjes;

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr.27, Kodi Postar 1001, Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: info@kmd.al, web: www.kmd.al

të informacionit të marrë në konfidencë, dhe garantimin e autoritetit të paanshmërisë së gjyqësorit;

3. Ndërhyrja është e nevojshme në një shoqëri demokratike.

Nevoja për të mbrojtur “të drejtat e të tjerëve” është një moment i rëndësishëm kufizues për të drejtën e shprehjes. Në çështjen *Engels and Others*, GJEDNJ është shprehur se: “*nuk ka arsye që të mohosh lirinë e shprehjes, por vetëm të dënosh ushtrimin abuziv të asaj lirie.....*”³³.

Më tej, Gjykata ka garantuar lirinë e medias duke u shprehur në mënyrë të përsëritur se: “*...kërkesa e përgjithshme që gazetarët të distancohen sistematikisht dhe formalisht nga përmbajtja e një citimi që mund të çojë në fyerje apo provokim të të tjerëve, apo të dëmtojë reputacionin e tyre nuk pajtohet me rolin e shtypit për të ofruar informacion mbi çështjet e ditës, opinionet dhe idetë.*”³⁴

Liria e shprehjes është një e drejtë Kushtetuese, e cila garantohet nga neni 22, pika 1, i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku parashikohet shprehimisht: “*Liria e shprehjes është e garantuar.*”

Liria e shprehjes, përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë dhe për të shprehur ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrje. Liria e mendimit dhe e shprehjes janë thelbësore për çdo shoqëri dhe përbëjnë gurin e themelit për zhvillimin e çdo personi dhe çdo shoqërie të lirë dhe demokratike.

Liria e mendimit, nuk i nënshtrohet asnjë kufizimi apo ndërhyrje. Asnjë person nuk mund të jetë subjekt i asnjë ndalimi ose kufizimi, për shkak të mendimeve/opinioneve të tij aktuale, të perceptuara apo të supozuara. Të gjitha format e mendimit janë të mbrojtura, duke përfshirë mendimet politike, shkencore, historike, morale ose të natyrës fetare. Liria e shprehjes, përfshin shprehjen/dhënien dhe marrjen e komunikimeve në çfarëdolloj forme të ideve dhe mendimeve, të cilat janë të transmetueshme tek të tjerët. Kjo lloj lirie nuk është absolute dhe është subjekt i kufizimeve. Ushtrimi i lirisë së shprehjes përmban në vetvete detyrime dhe përgjegjësi.

Liria e shprehjes është objekt i kufizimeve sipas përcaktimit të nenit 17, të Kushtetutës. Sipas kësaj dispozite kushtetuese, kufizimi i të drejtave dhe lirive të parashikuara në Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj, për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë. Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Referuar KEDNJ, kufizimi i këtyre të drejtave përcaktohet nga neni 9/2 dhe 10/2 si dhe neni 17 të saj.

Këto parashikime shkojnë në të njëjtën linjë edhe me rregullimin dhe nivelin e kufizimeve të zbatueshme për këto të drejta, të parashikuara nga traktatet e të drejtave të njeriut në kuadër të

³³ Engels and Others kundër Hollandës, 1976.

³⁴ Thoma kundër Luksemburgut, /64; Albert-Engelmann-Gesellschaft mbH kundër Austrisë.

Kombeve të Bashkuara, të cilat vendi ynë i ka ratifikuar, sikurse është Pakti për të Drejtat Civile dhe Politike. Ky traktat i të drejtave të njeriut rregullon ushtrimin dhe kufizimet e zbatueshme për këto të drejta në nenet 18/3 dhe 19/3 të tij të marra së bashku me nenin 20/2.

Sipas Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (në vijim GJEDNJ), kufizimet e vendosura nga neni 10/2 i KEDNJ, zbatohen jo vetëm për 'informacionet' ose 'idetë' që priten në mënyrë të favorshme ose konsiderohen si jofyese ose si çështje indiferente, por edhe për ato që ofendojnë, tronditin ose shqetësojnë shtetin ose çdo sektor të popullsisë. Të tilla janë kërkesat e atij pluralizmi, tolerance dhe mendjegjerësie pa të cilat nuk ka 'shoqëri demokratike'. Kjo do të thotë, ndër të tjera, se çdo 'formalitet', 'kusht', 'kufizim' ose 'dënim' i vendosur në këtë sferë duhet të jetë në proporcion me qëllimin legjitim të ndjekur". (*Handyside kundër Mbretërisë së Bashkuar, vendimi datë 7 dhjetor 1976, paragrafi 49*).

Toleranca dhe respekti për dinjitet të barabartë të të gjitha qenieve njerëzore përbëjnë themelet e një shoqërie demokratike dhe pluraliste. Duke qenë kështu, si një çështje parimi mund të konsiderohet e nevojshme që në shoqëri të caktuara demokratike të dënohen apo edhe të parandalohen të gjitha format e shprehjes të cilat përhapin, nxisin, promovojnë apo justifikojnë urrejtjen të bazuar tek mungesa e tolerancës. (*Erbakan kundër Turqisë, vendimi 6 korrik 2006, paragrafi 56*)

Ligji "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", i ndryshuar, i cili rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me një listë jo shteruese shkaqesh, duke përfshirë edhe gjininë, ndalon çdo formë të shprehjes në publik, me çdo mjet, të promovimit, nxitjes së denigrimit, urrejtjes ose shpifjes, çdo shqetësim, fyerje, stereotip negativ, stigmatizim ose kërcënim ndaj një personi ose grupi personash, si dhe çdo justifikim i të gjitha formave të shprehjes për këto shkaqe. Këto shprehje, përbëjnë "gjuhë urrejtje", e cila sipas ligjit përbën një nga format e shfaqjes së diskriminimit.

Kufizimi i gjuhës së urrejtjes duket se kërkon një pajtim të dy grupeve të vlerave: kërkesat e shoqërisë demokratike për të lejuar debat të hapur dhe autonomi dhe zhvillim individual me detyrimin gjithashtu bindës për të parandaluar sulmet ndaj komuniteteve a grupeve vulnerabël dhe për të siguruar pjesëmarrjen e barabartë dhe jodiskriminuese të të gjithë individëve në jetën publike.

Lidhur me pretendimin e subjekti ankues për përdorim të gjuhës së urrejtjes nga ana e Av. N, në emisionin "Më lër të flas", të datës 14.04.2023, Komisioneri ka analizuar regjistrimet e vëna në dispozicion nga autoriteti përkatës që mban dhe autorësinë e këtij materiali, televizioni Top Channel, konkretisht linkun:

<https://m.youtube.com/watch?v=3bsUu6WYRyU&pp=ygUdTWUgbGVyIHRIIGZsYXMgc3Bhc nRhayBuZ2plbGE%3D>.

Nga këqyrja e videoregjistrimit, lidhur me pjesën e pretenduar nga Shoqata, evidentohet se av. N, në bashkëbisedimin me prezantuesit e emisionit, lidhur me tematikën e tradhëtisë, ndër të tjera, është zhvilluar dialogu i mëposhtëm:

“...S. N: - Sipas legjislacionit anglez, nuk mund ta akuzosh ti tjetrin për përdhunim në rast se nuk ke rezistuar.

Prezantuesi 1: Duhet t’i kërkoshe leje a mund të të përdhunoj?

Prezantuesi 2: Me mesazh do të përdhunoj sot nga ora 4.

S. N: Eshhtë dhe scherzo e vajzës që bën sikur jo. Të akuzojnë X për përdhunim, në bazë të së drejtës penale angleze, ata matin sa e ke segmentin e rezistencës. Sepse vjen një moment i caktuar që femra...pasi femra është shtrënguar për përdhunim, dorëzohet nga kënaqësia. Prandaj duhet të jetë e lartë rezistenca që të dënohet..... ...gratë janë natyra më të dobëta, ata nuk rezistojnë dot, madje ndjejnë kënaqësi dhe në momentin që përdhunohen dhe më pas dorëzohen.”

Përsa më sipër, Komisioneri saktëson se, ka analizuar shprehjet e gjuhën e përdorur nga av. N, referuar dialogut më lart, të cilat i ka vlerësuar *se potencialisht kishin premisa për një gjuhë që shkon në tejkalim të lirisë së shprehjes.*

Kodi i Procedurës Administrative, i ndryshuar, në nenin 80, pika 3, e tij ka përcaktuar se: *“Faktet tashmë të njohura për autoritetin publik ose faktet e njohura botërisht dhe faktet e prezumuara nga ligji nuk kanë nevojë për prova të mëtejshme.”*

Gjuha e përdorur gjatë bisedës së zhvilluar mes prezantuesve dhe të ftuarve, konkretisht nga i ftuari av. N, cila është objekt shqyrtimi në këtë çështje, është bërë publike dhe si të tillë deklaratimet e subjektit konsiderohen të njohura publikisht dhe Komisioneri ka administruar në formën e kërkuar nga ligji, regjistrimin ku janë bërë deklaratimet të cilat janë marrë në shqyrtim.

Komisioneri evidenton faktin se, gjatë procedurës së shqyrtimit të kësaj çështjeje, në zbatim të hapave proceduralë, si dhe të pikës 9, të nenit 33, të LMD-së, ofroi mundësinë e arritjes së një marrëveshjeje ndërmjetësimi, dhe la në vlerësim të z. N, si njëri nga subjektet kundrejt të cilit ishte drejtur ankesa, nëse do të donte të konsideronte variantin e një zgjidhjeje miqësore të çështjes, pasi një kërkesë e tillë ishte paraqitur edhe nga vetë subjekti ankues gjatë seancës dëgjimore, të zhvilluar pranë KMD-së.

Subjekti ankues u deklarua gjatë seancës se ata do të tërhiqeshin nga ankesa kundrejt Av. N, nëse ai do të shpjegohej përmes një statusi apo qëndrimi në faqen e tij, në rrjetin social facebook. Në thelb të këtij qëndrimi duhet të ishte pohimi nga ana e tij i keqkuptimit të ndodhur përmes gjuhës së përdorur prej tij, kontekstit në të cilin shprehjet e referencat e një autori të huaj u përdorën si ilustrim, si dhe të kërkonte ndjesë publike për shqetësimin e krijuar kryesisht tek të gjitha ato femra të cilat mund të ishin pjesë e asaj kategorie ndaj të cilave ishte ushtruar dhunë fizike apo seksuale.

Komisioneri vëren se, nga ana e Av. N, nuk u konsiderua mundësia e shpjegimit të një keqkuptimi të mundshëm apo kërkimit të ndjesës publike, lidhur me impaktin negativ që u krijua nga përdorimi i shprehjeve të përdorura prej tij në emision³⁵.

Në kontekst të shprehjeve e gjuhës së përdorur në pasazhin, dialogun sipërcituar, si dhe qëndrimin e Av. N³⁶, Komisioneri, thekson se:

Së pari, përdorimi i referencave apo citimi i një autori të huaj të së Drejtës Penale Angleze, (J. Herring) nuk është objekt i analizës të KMD-së, dhe për rrjedhojë, citime të tilla në vetevete, nuk janë konsideruar si përdorim i gjuhës së papërshtatshme apo me nota diskriminuese, për sa kohë citohet autori dhe vepra ku janë referuar, por, vendosja e tyre jashtë kontekstit dhe pa asnjë lidhje me tematikën e hedhur për diskutim në panelin e të ftuarve, si dhe, mosmbajtja distancë, qëndrim-krijon imazhin dhe perceptimin publik se folësi është dakord dhe i përkrah thënie të tilla.

Së dyti, shprehjet dhe gjuha e përdorur gjatë emisionit nga Av. N, janë analizuar duke i kushtuar një rëndësi të veçantë faktit që janë përdorur në një televizion privat kombëtar si Top-Channel, në një orar dhe në kushtet kur shikueshmëria e këtij emisioni nga publiku është e konsiderueshme.

Po ashtu, duke patur në konsideratë edhe faktin se, emisioni në fjalë ishte publik dhe lehtësisht i aksesueshëm në faqen youtube, duke bërë të mundur që jehona e shprehjeve të përdorura të ketë një përhapje të gjerë në opinionin publik.

Së treti, duke patur në konsideratë edhe personalitetin e figurën e Av. N, si një person publik, avokat i mirënjohur, autor i një sërë veprash letrare, publicistike, juridike dhe të tjera, një person me përvojë të pasur jetësore, i dënuar politikisht për shkak të ushtrimit të lirisë së fjalës - pra, një figurë e shumëanëshme, e për këtë shkak i ftuar i përhershëm në televizione e media të tjera, për të analizuar e shprehur opinione për ngjarje të ndryshme politike, shoqërore, ndërkombëtare, etj. Pra, padiskutim, figura dhe fjala e z. N është me ndikim dhe impakt në publik.

³⁵ Referuar paragrafit të I-rë, fq 35 e Vendimit.

³⁶“... E drejta Penale, zotëri, parashikon edhe gënjeshtren e saj vajzës apo gruas që bën sikur, e cila, gjithashtu, është krim për kallëzim të rremë.

Në funksion të kësaj, ju vë në dijeni se:

E Drejta Penale Angleze, me autor J. Herring-botim shqip i Universitetit European të Tiranës, në volumnin e I, botimi i pestë, kapitulli 7, të tij, në faqet 421-499, ka veprat penale seksuale, në të cilin keni shumë më tepër nga ato që keni dëgjuar në televizion prej meje.

Në historinë e goditjes penale ka shumë vajza apo gra që gënjejnë – e dini ju këtë?

Dhe, e dini ju se, çfarë është drejtësia?

Zotëri, drejtësia është provë gjyqësore dhe jo mashtrim rrugësh; dhe godet edhe kallëzimin e rremë. Pikërisht për këtë është edhe karakteri shkencor i rezistencës së vajzës apo gruas në çështje të tilla, të cilën na sqaron teorikisht dhe shkencërisht, në fubnksion të psikologjisë njërëzore. E Drejta Penale që ju citova”.

Lidhur me sa më sipër, Komisioneri, referuar edhe provave të depozituara nga subjekti ankues, ka konstatuar se në rrjete sociale, janë shfaqur komente jo të përshtatshme, me natyrë seksiste, nota fyese e përcmuese, të personave të tjerë, lidhur me gjuhën dhe shprehjet e përdorura nga av. N.

Në analizën që KMD i ka bërë gjuhës së përdorur në këtë emision nga Av. N, ka vlerësuar se përdorimi i saj konsiderohet në tejkalim të lirisë së shprehjes të sanksionuar në nenin 14 të KEDNJ-së dhe nenin 22 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Në këtë kontekst, KMD, në analizën e tij, i është referuar kufizimeve që parashikon KEDNJ për lirinë e shprehjes, të parashikuar në nenin 10, të saj dhe qëndrimin të mbajtur nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut.

Ushtrimi i lirisë së shprehjes përmban në vetvete detyrime dhe përgjegjësi. Sipas paragrafit të dytë të nenit 10 të Konventës, ushtrimi i kësaj lirie nuk mund të çenojë dinjitetin dhe të drejtat e të tjerëve. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka theksuar në gjykime të ndryshme se: *“Toleranca dhe respekti për dinjitetin e barabartë të të gjitha qenieve njerëzore përbëjnë themelet e një shoqërie demokratike dhe pluraliste. Duke qenë kështu, si çështje parimore mund të konsiderohet e nevojshme në disa shoqëri demokratike që të sanksionojnë ose madje të parandalojnë të gjitha format e shprehjes që përhapin, nxisin, promovojnë ose justifikojnë urrejtjen e bazuar në jo tolerancë ..., me kusht që çdo “formalitet”, “kusht”, “kufizimet ose gjokat” janë proporcionale me qëllimin legjitim të ndjekur. (Erbakan v. Turkey, Aktgjykimi i 6 korrikut 2006, § 56)”*. Duke qenë kështu lind nevoja e parandalimit të të gjitha formave të shprehjes të cilat përhapin, nxisin, promovojnë ose justifikojnë urrejtjen bazuar në mungesën e tolerancës.

Përveç sa më sipër, KMD gjykon se për rastin konkret është me vend të përmendet edhe Rekomandimi i Politikave të Përgjithshme Nr. 15 për Luftimin e Gjuhës së Urrejtjes, 8 Dhjetor 2015, i Komisionit Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës, i cili është një akt shumë i rëndësishëm, që u drejtohet qeverive të Shteteve anëtare të Këshillit të Evropës dhe që fokusohet në fenomenin e gjuhës së urrejtjes dhe pasojat e dëmshme të përdorimit të saj për individët, grupe të caktuara personash dhe shoqërinë në tërësi.

Gjuha e urrejtjes për qëllimin e Rekomandimit nënkupton përdorimin e një ose më shumë formave të veçanta të shprehjes - përkatësisht, avokimin, promovimin ose nxitjen e denigrimit, urrejtjes apo përgojimit të një personi ose grupi personash, si dhe çdo ngacim, fyerje, stereotipizim negativ, stigmatizim ose kërcënim i një personi ose personave të tillë dhe çdo justifikim të të gjitha këtyre formave të shprehjes - që bazohet në një listë joshtruese të karakteristikave personale apo statusit që përfshin racën, ngjyrën, gjuhën, fenë ose besimin, kombësinë ose prejardhjen kombëtare apo etnike, si dhe prejardhjen prindërore, moshën, aftësinë e kufizuar, seksin, *gjininë*, identitetin gjinor dhe orientimin seksual.

Në këtë Rekomandim, elementët domethënës të konceptit “gjuhë urrejtje”, lidhen me:

- promovimin apo nxitjen e çfarëdo forme denigrimi, urrejtjeje apo përgojimi, si edhe ngacmimin, fyerjen, stereotipizimin negativ, stigmatizimin apo kërcënimin;
- përdorimin që synon jo thjesht të nxitë kryerjen e akteve të dhunës, frikësimit, armiqësisë apo diskriminimit, por edhe pritshmërinë e arsyeshme që ky përdorim të ketë këto efekte; dhe;
- shkaqet që shkojnë përtej “racës”, ngjyrës, gjuhës, fesë apo besimit, kombësisë, prejardhjes kombëtare apo etnike apo prejardhjes prindërore.

“Shprehja” sipas këtij Rekomandimi përfshin fjalët dhe publikimet në çfarëdo formë, përfshirë edhe përmes medias të çdo forme, si edhe përhapjen dhe ruajtjen e tyre. Gjuha e urrejtjes mund të marrë formën e fjalëve të shkruara apo të shqiptuara, apo forma të tjera si foto, imazhe, shenja, simbole, piktura, muzikë, pjesë teatrale apo video. Ndërkohë që, format e shprehjes që janë në fushën e veprimit të Rekomandimit mund të përfshijnë edhe mohimin publik, banalizimin, justifikimin apo legjitimimin për krimet e gjenocidit, krimet kundër njerëzimit ose krimet e luftës, të cilat janë konstatuar nga gjykatat, si edhe lartësimin e personave për kryerjen e krimeve të tilla.

Nëpërmjet këtij Rekomandimi, ndër të tjera, shteteve palë u rekomandohet që “të ofrojnë mbështetje individuale dhe kolektive për personat e shënjestruar nga gjuha e urrejtjes ...”³⁷ si dhe “të përdorin fuqitë rregullatore në drejtim të medias (përfshirë ofruarit e shërbimit të internetit, ndërmjetësit online dhe median sociale) që të promovojnë veprimet për të luftuar përdorimin e gjuhës së urrejtjes dhe të kontestojnë natyrën e papranueshme të saj, duke u siguruar njëkohësisht që masa të tilla të mos përbëjnë shkelje të lirisë së shprehjes dhe mendimit...”³⁸ nëpërmjet ndërmarrjes së veprimeve të caktuara në këtë akt.

Praktika e GJEDNJ-së, gjithashu, është e pasur lidhur me vendimmarrjet mbi çështjet, ku objekt gjykimi ka qenë gjuha e urrejtjes. Në çështjet Féret k. Belgjikës, (2007) dhe Vejdeland dhe të tjerë k. Suedisë, (2012), GJEDNJ ka pranuar se nxitja e urrejtjes mund të rezultojë në fyerje, tallje apo shpifje ndaj grupeve të caktuara të popullsisë, kur këto forma të shprehjes ushtrohen në mënyrë të papërgjegjshme, që nënkupton se është fyese në mënyrë të panevojshme, avokon diskriminimin apo përdor gjuhë cenuese apo poshtëruese ose i imponohet publikut në mënyrë të pashmangshme dhe këto forma janë brenda fushës së veprimit të përkufizimit të Rekomandimit të sipërcituar.

Në çështjen Garaudy kundër Francës, (2003), GJEDNJ u mbështet në nenin 17 të KEDNJ-së dhe u shpreh se liria e shprehjes nuk mund të përdoret për të çuar në shkatërrimin e të drejtave dhe lirive të tjera, të garantuara nga Konventa. Këto vendime zbatojnë teorinë e paradoksit të tolerancës: një tolerancë absolute mund të çojë në tolerancën e ideve që nxisin mostolerancë dhe kjo e fundit mund të asgjësojë tolerancën³⁹.

³⁷ Referuar pikës 5 të Rekomandimit të Politikave të Përgjithshme Nr. 15 për Luftimin e Gjuhes së Urrejtjes (2015)

³⁸ Referuar pikës 7 të Rekomandimit të Politikave të Përgjithshme Nr. 15 për Luftimin e Gjuhes së Urrejtjes (2015)

³⁹ Siniarska D.B, (2015) Manual për praktikantët e ligjit - Mbrojtja e së drejtës për lirinë e shprehjes sipas Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, faqja 12, paragrafi 1;

Gjithashtu, Rekomandimi CM/Rec (2013), miratuar nga Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës për Shtetet Anëtare “*Mbi barazinë gjinore dhe median*”, citon se: “*Barazia gjinore është një kusht i domosdoshëm për gëzimin e plotë të të drejtave të njeriut. Gëzimi i të drejtave siç janë dhënë nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (ETS nr. 5) dhe protokollet e saj do të garantohet pa asnjë diskriminim, përfshirë edhe ato për arsye të seksit. Kjo kërkesë është përforcuar me anë të Protokollit Nr. 12 të Konventës (ETS Nr. 177), e cila garanton gëzimin e çdo të drejte të njohur nga ligji pa diskriminim.*”

Në vijim Rekomandimi CM/Rec (2013), parashikon se: “*...Barazi gjinore do të thotë prezantim publik të barabartë, fuqizim, përgjegjësi dhe pjesëmarrje si të grave ashtu dhe burrave në të gjitha sferat e jetës publike, duke përfshirë mediat. Liria e medias (duke përfshirë lirinë redaktoriale) dhe barazia gjinore janë në thelb të ndërlidhura. Barazia gjinore është një pjesë integrale e të drejtave të njeriut. Liria e shprehjes, si një e drejtë themelore, shkon krahpërkrah me barazinë gjinore. Për më tepër, ushtrimi i lirisë së shprehjes mund ta avancojë barazinë gjinore...Media është në qendër të formësimit të perceptimeve, ideve, qëndrimeve dhe sjelljeve të shoqërisë...Media ose mund ta pengojë ose ta shpejtojë ndryshimin strukturor drejt barazisë gjinore. Pabarazitë në shoqëri riprodhohen në media.*”

Rekomandimi CM/Rec (2019), miratuar nga Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës, më date 27 mars 2019 “*Parandalimi dhe luftimi i seksizmit*”, citon ndër të tjera se: “*...aktet e seksizmit “të përditshëm” në formën e sjelljeve, komenteve dhe shakave seksiste, në dukje të vogla dhe të padëmshme, janë në skaj të kësaj vazhdimësie. Megjithatë, këto akte shpesh janë poshtëruese dhe kontribuojnë në një klimë sociale ku gratë përulen, vetëvlerësimi i tyre ulet dhe aktivitetet dhe zgjedhjet e tyre kufizohen, përfshirë në punë, në sferën private, publike ose në internet. Sjellja seksiste, e sidomos gjuha e urrejtjes seksiste, mund të përshkallëzohet ose të nxisë veprime të qarta fyese dhe kërcënuese, përfshirë abuzimin seksual ose dhunën, përdhunimin ose ndonjë veprim që mund të jetë vdekjeprurës. Pasoja të tjera mund të përfshijnë humbjen e burimeve të jetesës, vetë-dëmtimin ose vetëvrasjen. Prandaj trajtimi i seksizmit është pjesë e detyrimit pozitiv të shteteve për të garantuar të drejtat e njeriut, barazinë gjinore dhe për të parandaluar dhunën ndaj grave dhe vajzave në përputhje me legjislacionin ndërkombëtar të të drejtave të njeriut dhe për shtetet palë të Konventës së Stambollit.*”

Rekomandimi CM/Rec (2019), e përkufizon seksizmin dhe sjelljet seksiste, duke parashtruar se: “*Seksizmi dhe sjellja seksiste rezultojnë në dëmtime fizike, seksuale, psikologjike ose socioekonomike dhe ndikojnë në mënyra të ndryshme në sektorë të caktuar të popullatës. Gratë dhe vajzat preken në mënyrë disproporcionale nga sjellje të tilla. Seksizmi dhe sjellja seksiste përbëjnë pengesë për fuqizimin dhe përparimin e grave dhe vajzave; nga eliminimi i seksizmit dhe sjelljes seksiste do të përfitonin të gjithë: gratë, vajzat, burrat dhe djemtë.*”

GJEDNJ ka trajtuar jo vetëm rastet e përdorimit të gjuhës së urrejtjes nga subjekte të caktuara, por edhe rastet kur nga subjekte të tjera në lidhura me ta, nuk është mbajtur qëndrim kritik ndaj

përdorimit të kësaj gjuhe. Kështu, në çështjen *Erbakan kundër Turqisë*, 6 korrik 2006, GJEDNJ është shprehur se, në parim, mund të konsiderohet e nevojshme që në shoqëri të caktuara demokratike të dënohen apo edhe të parandalohen të gjitha format e shprehjes të cilat përhapin, nxisin, promovojnë apo justifikojnë urrejtjen të bazuar tek mungesa e tolerancës. Në çështjen *Handyside kundër Mbretërisë së Bashkuar 1976*, GJEDNJ është shprehur se e drejta e individëve, për të shprehur lirisht mendimet e tyre nuk duhet të “fyejë, tronditë apo shqetësojë” të tjerët.

Në çështjen *Vejdeland dhe të tjerë kundër Suedisë*, GJEDNJ-ja mban qëndrimin se, në disa raste ndërhyrja në lirinë e shprehjes është e domosdoshme në një shoqëri demokratike, për shkak të mbrojtjes së reputacionit dhe të drejtave të të tjerëve.

Komisioneri, gjykon se, dhuna verbale, psikologjike dhe shprehje të gjuhës seksiste dhe denigruese janë të papranueshme dhe për më shumë të dënueshme kur përdoren në hapësira publike mediatike, në emisione me audiencë të gjerë dhe në fasha orare me rezonancë të lartë të popullsisë, ku përfshihen edhe fëmijët dhe të rinjtë.

Është fakt që në Shqipëri, akoma dhe në ditët e sotme, gratë/vajzat, ndeshen me një sërë veprimesh paragjyquese e diskriminuese, shoqëruar dhe me një gjuhë të urrejtjes, dhunë e lëndime. Barazia dhe mbrojtja e tyre nga diskriminimi “de-jure” jo gjithmonë respektohet dhe shoqërohet me drejtësi “de-facto”.

Lidhur me analizimin e gjuhës së përdorur nga Av. N, Komisioneri ka mbajtur parasysht impaktin e saj në publikun që e ka ndjekur, bazuar në kontekstin historik, social e kulturor të realitetit shqiptar.

“Përcaktimi i karakteristikave mbrojtëse gjithashtu kërkon edhe të kuptuarit e historisë së represionit dhe diskriminimit në shtetin konkret, si dhe problemet aktuale shoqërore të tij. Së këtejmi, në karakteristikat e mbrojtura duhet të përfshihen edhe ato karakteristika që kanë qenë bazë të diskriminimit ose shtypjes në të kaluarën dhe të atyre që janë bazë për incidentet aktuale ose bashkëkohore të diskriminimit ose shtypjes.”⁴⁰

Çdo fjalim detyrimisht interpretohet konform përmbajtjes së tij, por edhe në kontekstin në të cilin shprehet. Për këtë shkak çdoherë është e domosdoshme të vlerësohet konteksti në të cilin është realizuar shprehja. Gjuha e urrejtjes shkakton dëm të madh si ndaj një individi konkret, përkatësisht grupi të cilit i adresohet, ashtu edhe ndaj shoqërisë në tërësi.

⁴⁰ Lawrence, Frederick M., *Punishing Hate: Bias Crimes under American Law*, Harvard University Press, Cambridge, Massachusetts, 1999. Gjithashtu edhe në OSCE, *Hate Crime Laws: A Practical Guide*, Published by ODIHR, Warsaw, Poland, 2009, pp 38-39.

Gjuha e urrejtjes shkakton dhimbje emocionale dhe psikike tek viktimat, ndikon mbi mobilizimin shoqëror dhe prosperitetin gjatë punës: përgjigjet psikike të këtyre sulmeve verbale përbëhen nga ndjenja e përcmimit, izolimit, urrejtjes së vetvetes dhe dyshimit ndaj vetvetes.

Gjuha e urrejtjes ka ndikim të dëmshëm dhe mbi kualitetin e jetës së shoqërisë: duke i bërë anëtarët e komunitetit të viktimizuar si frikacakë, të hidhëruar dhe të dyshimtë ndaj grupeve të tjera dhe ndaj strukturës së fuqisë e cila do të duhet t'i mbronte – kjo gjuhë ka kapacitet në mënyrë serioze ta dëmtojë strukturën shoqërore dhe t'i ndajë komunitetet.

Në kontekstin shqiptar, ku bazuar në të dhënat statistikore të organizmave/institucioneve të ndryshme shtetërore apo jo, evidentohet se, rastet e dhunës (përfshirë edhe dhunës seksuale) të raportuara ose jo të raportuara, nga ose për femrat janë të niveleve shqetësuese.

Referuar dokumentit **“Dhuna ndaj grave dhe vajzave në Shqipëri (DhNG)” – vrojtim kombëtar me bazë popullatën⁴¹ (botuar në prill 2019)**, pasqyrohet situata si më poshtë:

- DhNG-ja nuk është një fenomen i ri në Shqipëri. Ajo ka rrënjë të thella në traditat dhe zakonet patriarkale të cilat prej kohësh i kanë dhënë formën Shqipërisë, përfshirë identitetet dhe rolet e ngurta gjinore, dhunuesit patriarkalë, respektimin e sistemit të nderit dhe turpit, zakonet e urdhrave hierarkike brenda familjes dhe kontrollin midis brezave në familje.
- Në lidhje me përjetimet aktuale të dhunës, 1 në 3 gra, kanë përjetuar dhunë gjatë 12 muajve përpara vrotimit. Në veçanti, 1 në 3 gra, kanë përjetuar dhunë në familje nga partneri intim dhe 61,8% kanë përjetuar dhunë gjatë marrëdhënieve dashurore gjatë 12 muajve përpara vrotimit. Nga të gjitha gratë e moshës 18-74 vjeç, 3,4% kanë përjetuar dhunë nga jopartneri, 8,5% kanë përjetuar ngacmime seksuale dhe 6,9% kanë përjetuar përndjekje në 12 muajt përpara vrotimit.
- Analiza e mëtejshme nxori në pah një lidhje të fortë midis dhunës së ushtruar nga partneri intim dhe dhunës së ushtruar nga jopartneri. Në veçanti, 3 në 4 ose 75,8% e grave që kanë përjetuar dhunë nga jopartneri që në moshën 15 vjeç kanë përjetuar dhunë në familje edhe nga partneri intim. Me fjalë të tjera, gratë që kanë përjetuar dhunë nga jopartnerët që në moshën 15 vjeç kishin dy herë më shumë gjasa të përjetonin dhunë në familje nga partneri intim (75,8%), krahasuar me gratë që nuk kishin përjetuar dhunë nga jopartnerët që në moshën 15 vjeç (32,1%). Gjithashtu vrotimi konstatoi se 3,1% e grave të moshës 18-74 vjeç ishin abuzuar seksualisht gjatë fëmijërisë, domethënë, ishin prekur seksualisht kur nuk kishin dashur apo ishin detyruar të bënin diçka seksuale që nuk kishin dashur ta bënin. Analiza eksploroi marrëdhënien midis abuzimit seksual të fëmijës dhe dhunës me bazë gjinore në

⁴¹ Ky vrotim u krye nga INSTAT me ekspertizën teknike të Dr. Robin, konsulente ndërkombëtare, edhe shkrimi i tij u kryesua nga Robin Haarr, me mbështetjen e UNDP-së dhe UN Women dhe me ndihmën financiare të Qeverisë së Australisë, në kuadër të projektit rajonal për statistikat gjinore dhe të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm “Të bëjmë që çdo grua dhe vajzë të ketë rëndësi” dhe të Qeverisë Suedeze në kuadër të Programit të përbashkët të Kombeve të Bashkuara T’i japim fund Dhunës ndaj Grave në Shqipëri. Opinionet dhe mendimet e shprehura në këtë raport nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht mendimet e UNDP-së, UN Women dhe donatorëve të tyre.

moshë të rritur. Grafiku 2 tregon se gratë që kanë përjetuar abuzim seksual në fëmijëri kishin më shumë të ngjarë që të përjetonin dhunë me bazë gjinore në moshë të rritur (88.8%), krahasuar me gratë që nuk kishin përjetuar abuzime seksuale në fëmijëri (51.5%). Gratë që kishin përjetuar abuzime seksuale si fëmijë po ashtu kishin më të ngjarë të përjetonin dhunë në familje nga partneri intim (64.6%) dhe dy herë më të ngjarë të përjetonin dhunë nga jopartneri (41.9%), krahasuar me gratë që nuk kishin përjetuar abuzim seksual në fëmijëri (përkatesisht 39.2% dhe 17.7%).

- 11.4% e grave mendonin së të gjithë apo shumica e burrave në komunitet i qëllonjë apo i rrahin gratë sepse refuzojnë të kryejnë marrëdhënie seksuale me ta.
- Në lidhje me normat shoqërore të lidhura me dhunën seksuale, 26.1% e grave të moshës 18-74 vjeç mendonin se të gjithë apo shumica e njerëzve në komunitet besojnë se gruaja duhet të ketë turp apo të ndihet keq të flasë me dikë nëse është përdhunuar, dhe 21.2% e grave mendonin se të gjithë apo shumica e njerëzve në komunitet besojnë se nëse një grua përdhuhet, ka të ngjarë që të ketë bërë diçka të pakujdesshme që e ka vënë veten në një situatë të tillë.
- Duke pasur parasysh këto gjetje, nuk është për t'u habitur që shumica e grave ishin të mendimit se është shumë e rëndësishme të ketë ligje në Shqipëri që të mbrojnë gratë dhe vajzat nga dhuna në martesë/familje (83.0%) dhe nga sulmet seksuale dhe përdhunimi (81.9%).
- 47.0% e grave kanë përjetuar dhunë në familje nga partneri intim. Më konkretisht, 41.2% e grave kanë përjetuar “ndonjëherë” sjellje kontrolluese shtrënguese, 31.4% kanë përjetuar dhunë psikologjike, 18.0% kanë përjetuar dhunë fizike, 8.6% kanë përjetuar dhunë seksuale, dhe 7.0% kanë përjetuar dhunë ekonomike. Njëzetë e një për qind e grave “kanë përjetuar ndonjëherë dhunë fizike dhe/ose dhuna seksuale, ose të dyja”.
- 1 në 3 gra kanë përjetuar dhunë në familje nga partneri intim gjatë 12 muajve përpara vërtimit. Më konkretisht, 1 në 4, ose 25.2% e grave kanë përjetuar sjellje kontrolluese shtrënguese, 19.7% kanë përjetuar dhunë psikologjike, 7.2% kanë përjetuar dhunë fizike, 7% kanë përjetuar dhunë ekonomike, dhe 3.6% kanë përjetuar dhunë seksuale gjatë 12 muajve përpara vërtimit. Është për të vënë në dukje se 8.2% e grave kanë përjetuar dhunë fizike dhe/ose dhunë seksuale, ose të dyja, gjatë 12 muajve përpara vërtimit. Evidentohet dhuna seksuale ndaj grave edhe nga partneri intim.
- Midis grave të moshës 18-74 vjeç, 18.2% kanë përjetuar “ndonjëherë” dhe 2.4% “aktualisht” një ose më shumë lloje dhune nga jopartneri që në moshën 15 vjeç (nga një njeri tjetër nga bashkëshorti/i dashuri). Gratë kishin më të ngjarë të përjetonin dhunë fizike nga jopartneri (17.3%) se sa dhunë seksuale nga jopartneri (1.3%).
- Midis grave që kanë përjetuar “ndonjëherë” dhunë fizike nga partneri që në moshën 15 vjeç, shumica raportuan se dhunuesi ka qenë nëna/njerka (76.1) dhe babai/njerku (58.0%). Gjithashtu, 35,7% identifikuan dhunuesin si mësuesin dhe 28.0% identifikuan vëllain apo motrën. Gratë identifikuan një shumëllojshmëri dhunuesish, por në një shkallë më të vogël.
- Gratë që kanë përjetuar dhunë seksuale nga jopartneri që në moshën 15 vjeç i kanë përcaktuar autorët e dhunës si: shoqe/shokë klase (15.1%); mësues (7.1%); shokë/të njohur (5.4%); babai/njerku (5.2%); nëna/ njerka (4.4%); dhe, të panjohur (3.3%).

- Ky studim për DhNG-në ishte i treti që INSTAT-i ka kryer në Shqipëri dhe mund të shërbejë për informimin e reagimeve me politika dhe veprime në terren. Gjetjet e Vrojtimet Kombëtar për Dhunën ndaj Grave (VKDhNG) tregojnë se DHNG-ja është e përhapur, por tepër e nën-raportuar në Shqipëri. Duke pasur parasysh këto gjetje, DHNG-ja nuk mund të shihet si një çështje anësore që prek vetëm jetën e disa grave në Shqipëri. DHNG-ja prek shumicën e grave dhe rezulton në ekspozimin e fëmijëve ndaj dhunës në familje.
- Roli i medias në shoqërinë e sotme dinamike është provuar të jetë mjaft ndikues, jo thjesht si një informues për ngjarjet, por më së shumti si drejtues i fokusit, opinion-formues dhe madje edukues i prirjeve dhe qëndrimeve publike të kohës. (Griffin, 2005: 403). Dhe kjo është e kuptueshme, po të kemi parasysh faktin se mediat arrijnë një audiencë të gjerë në një kohë relativisht të shkurtër, kanë zë të fuqishëm dhe mund të trajtojnë me gjerësi tema të caktuara (veçanërisht kur flasim për median e shkruar), veçori që lidhen ngushtë dhe me prirjen e audiencës së sotme për të shpenzuar kohë të konsiderueshme me median, siç pranon Woods, *“Media depërton në gjithë jetën tonë”* (2005: 232).

Në 1993, Deklarata e Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave ishte i pari dokument ndërkombëtar i të drejtave të njeriut që trajtoi këtë çështje.

“Platforma e Pekinit” (1995) e përfshiu “Dhunën ndaj gruas” si një nga 12 çështjet kritike për t’u adresuar nga qeveritë dhe aktorët e tjerë. Gjithashtu, tërhoqi vëmendjen e medias lidhur me “produktet mediatike të dhunshme ose pornografike...që ndikojnë në mënyrë negative gratë dhe pjesëmarrjen e tyre në shoqëri”.

Në vitet pas *“Platformës për Veprim të Pekinit”* diskutimi mes lidhjeve të medias dhe dhunës u fokusua në dy çështje kryesore:

- Shkalla në të cilën aspektet negative dhe stereotipizuese të imazheve të grave në media mund të kontribuojnë në dhunën gjinore në shoqëri;
- Si dhe mbulimi mediatik i incidenteve të dhunës ndaj grave.

Në nenin 5 të Konventës për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas (CEDAW) thuhet se:

Shtetet palë marrin të gjitha masat e përshtatshme me synimin që:

- Të ndryshojnë skemat dhe modelet e sjelljes shoqërore dhe kulturore të burrit dhe të gruas, në mënyrë që të arrijnë të zhdukin paragjykimet dhe praktikat zakonore, ose të çdo lloji tjetër, që mbështeten në idenë e inferioritetit ose të epërsisë së njërit apo të tjetrit seks, apo në rolin stereotip të burrit dhe të gruas.

Në Rekomandimet mbi Barazinë mes Grave dhe Burrave në Media të Këshillit të Evropës theksohet se: “Media luan një rol të rëndësishëm në formimin e qëndrimeve dhe vlerave të individëve si dhe shërben si një instrument i dobishëm për ndryshimet sociale.”

Në vitin 1999, në një video-konferencë globale organizuar nga UNIFEM në bashkëpunim me agjenci të tjera të Kombeve të Bashkuara, u diskutua **roli i medias** si *mjet për të rritur*

efektivitetin e agjencive të tjera për minimizimin e dhunës ndaj grave dhe si një fokus specifik për avokaci për eliminimin e dhunës. Në këtë konferencë u theksua fakti se “Media ka një rol kryesor në stimulimin e debatit publik, ekspozimin e frekuencës dhe egërsinë e dhunës ndaj gruas dhe sigurimit të një forumi për eksplorimin e strategjive në fusha të tjera.”

Ndërsa në Platformën për Arritjen e Barazisë Gjinore (Roadmap to Gender Equality 2006-2010) të Komunitetit Evropian theksohen gjashtë fusha prioritare për vitet 2006- 2010, duke përfshirë:

....

- minimizimin e të gjitha formave të dhunës me bazë gjinore;
- eliminimin e stereotipeve gjinore.

Në Konferencën e Katërt Botërore të Pekinit e mbajtur në shtator 1995, dhuna në familje u përkufizua si *“një problem mbarëbotëror dhe që duhet trajtuar si i tillë.”* Po në këtë konferencë është theksuar se *“dhuna ndaj gruas përbën dhunim të të drejtave njerëzore, si dhe një pengesë në arritjen e barazisë, zhvillimit dhe paqes.”*

Sipas përmbajtjes së këtij dokumenti, **dhuna seksuale** përfshin: marrëdhënie seksuale me forcë; trajtimin e partneres si objekt seksual; detyrimin për të bërë seks pa dëshirën e partneres; detyrimin për të realizuar seks në forma të padëshiruara dhe të papranueshme për partneren; këmbënguljen për të prekur e për të bërë gjithçka që dëshiron partneri; detyrimin për të bërë seks me një partner tjetër në sy ose jo të vetë bashkëshortit/partnerit; realizimi i marrëdhënieve seksuale me një partnere tjetër në sy të bashkëshortes; deklarimi për një lidhje jashtëmartesore; detyrimi për të kryer marrëdhënie seksuale pas ushtrimit të dhunës fizike; detyrimi për të bërë prostitucion; detyrimi për të bërë striptizë; etj. Mbështetur nga të dhënat e qendrave të këshillimit kjo është forma e tretë e dhunës që deklarohet nga gratë viktime. Në këtë rast duhet nënvizuar fakti se ndonëse një dhunë e pastër seksuale mund të jetë e treta për sa i përket frekuencës së saj, ajo është gjithnjë e implikuar dhe e gërrshetuar me format e tjera të dhunës si dhuna emocionale dhe ajo fizike.

Gjithashtu, në këtë dokument, shprehet qartë se, **mënyra se si shoqëria e konsideron dhunën në përgjithësi dhe si reflektohet nga media**, varfëria dhe papunësia, pabarazitë gjinore, niveli i lartë i stresit, rënia e konsiderueshme e nivelit të arsimit, humbja e besimit në institucionet shtetërore, vështirësitë në zbatimin e ligjit mbi dhunën në familje, modelimi i sjelljeve agresive që shfaqen në sferën politike, mungesa e shërbimeve në mbështetje të familjeve, paqëndrueshmëria politike dhe ekonomike, varfëria, etj, **janë faktorë që ndikojnë në shtimin e dhunës.**

Lidhur me frekuencën apo të dhënat statistikore të dhunës në familje në Shqipëri, ndër vite, paraqitet situatë si më poshtë:

Sipas një studimi të vitit 1996 të kryer në një kampion përfaqësues kombëtar të grave në Shqipëri (849 gra), përhapja e dhunës ndaj tyre (fizike, seksuale, apo psikologjike) u raportua të ishte 64%.

Sipas një studimi të kryer në Tiranë në vitin 2003 i cili përfshiu një kampion përfaqësues prej 1039 grash të martuara, përhapja e dhunës fizike u raportua të ishte e lartë. Kështu, së paku një episod i dhunës fizike (gjatë vitit të fundit) u raportua nga 37% e grave të intervistuar, ndërkohë që 26% e grave raportuan së paku tre episode të dhunës fizike gjatë vitit të fundit. Përhapja e dhunës fizike ishte më e lartë tek gratë, burrat e të cilave kishin një nivel edukimi prej jo më shumë se 9 vitesh dhe ishin me origjinë rurale.

Sipas një publikimi të *Amnesty International (Prill 2006)*, 1 në 3 gra në Shqipëri, është dhunuar fizikisht brenda familjes së saj. Në shumicën dërrmuese të rasteve, të përgjegjshëm për aktet e dhunës janë partnerët e tyre. Po sipas këtij publikimi 52.2% e grave që vuajnë nga dhuna në familje, nuk u kanë folur kurrë të tjerëve për dhunën e ushtruar ndaj tyre. Kjo shifër shpreh mungesën e ndërgjegjësimit të grave, që nuk e shohin dhunën si një akt që duhet denoncuar. Sipas një monitorimi të katër periodikëve kryesorë shqiptarë të bërë nga Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim, vetëm gjatë periudhës Korrik-Gusht 2008 kanë ndodhur 26 raste vetëvrasjesh të gratë e vajzat. Nga analizimi i artikujve për rastet e vetëvrasjeve shikohet se ndër shkaqet kryesore janë *dhuna në familje* dhe problemet ekonomike.

Duke iu referuar statistikave në raportin 6-mujor të policisë shkruar në artikullin “*Vetëvrasjet, sa dyfishi i vrasjeve*” (*Panorama, 27.07.08*) gjatë këtij 6-mujori, 88 është numri i krimeve kundër vetes ku: 73 raste janë vetëvrasje dhe 15 tentativa për vetëvrasje, kjo tregon një numër relativisht të lartë në krahasim me vrasjet, të cilat për këtë gjysëm viti kanë qenë 44 raste. *Sipas raportit të policisë thuhet se dhuna në familje klasifikohet si një nga shkaqet kryesore të vetëvrasjeve, ku në 95% të rasteve të shtyra nga dhuna, të dhunuarat kanë qenë bashkëshortet, vajzat dhe nënat. Pra, gratë vazhdojnë të mbeten seksi më i diskriminuar dhe më i dhunuar në familje, gjë që po reflektohet edhe në rastet e vetëvrasjeve, si pasojë e dhunës në familje. Në raport theksohet se “...mbi 50% e rasteve të denoncuarra i përkasin Tiranës, ndërsa në rrethet duket se konsiderohet ende tabu denoncimi prej të dëmtuarve i dhunës së ushtruar në familje”.*

Të dhënat mbi përhapjen e fenomenit të dhunës në familje vazhdojnë të jenë të kufizuara. Kështu komisariatet e policisë, zyrat juridike, qendrat e kujdesit shëndetësor dhe ato të shërbimeve sociale nuk janë të detyruara me ligj të grumbullojnë dhe prezantojnë të dhëna mbi dhunën. Shqipëria është një nga vendet e pakta në Evropë që nuk regjistron, publikon dhe prezanton zyrtarisht rregullisht të dhëna mbi përmasat dhe përhapjen e këtij fenomeni.

Në publikimin e bërë nga Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri (AWEN) në kuadrin e programit “Mbrotjtje dhe Promovim i të Drejtave të Grave në Shqipëri”, me mbështetjen financiare të Qeverisë Suedeze, në vitin 2022, me titull: “*Dhuna seksuale dhe ngacmimi seksual – Një analizë e situatës*”, në fjalorthin e termave, bëhen cilësimet e mëposhtme:

Dhunë, sipas ligjit 9669/2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar me ligjin 47/2018, neni 3 përkufizohet: “*Çdo veprim ose mosveprim i një personi ndaj një*

personi tjetër, që sjell si pasojë cenim të integritetit fizik, moral, psikologjik, seksual, social, ekonomik.”

Viktimë, sipas të njëjtit ligj cituar më sipër, cilësohet: “Personi mbi të cilin është ushtruar çdo veprim ose mosveprim i një personi tjetër, që sjell si pasojë cenim të integritetit fizik, moral, psikologjik, seksual, social, ekonomik.”

Dhunë në familje, konsiderohet: “Çdo akt i dhunës fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike që ndodh brenda familjes ose njësisë shtëpiake ose midis bashkëshortëve ose partnerëve ose midis ish -bashkëshortëve ose ish-partnerëve, pavarësisht nga fakti nëse dhunuesi ndan ose ka ndarë të njëjtën banesë me viktimën.”

Ligji “Për Masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar, e përkufizon dhunën si: “çdo akt dhune i përcaktuar sipas pikës 1 të këtij neni, që ndodh brenda familjes ose njësisë shtëpiake, e ushtruar ndërmjet pjesëtarëve të familjes, të përcaktuar në pikën 7 të këtij neni, që janë ose kanë qenë në marrëdhënie familjare, pavarësisht nga fakti nëse dhunuesi ndan ose ka ndarë të njëjtën banesë me viktimën.”

Neni 130/a i Kodit Penal të Shqipërisë e përkufizon dhunën në familje si “rrahja, si edhe çdo veprë tjetër dhune ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish -bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt me autorin e veprës penale, me pasojë cenimin e integritetit fizik, psiko-social dhe ekonomik të tij.”

Dhuna fizike përkufizohet si: “Përdorimi i forcës fizike kundër dikujt në një mënyrë që lëndon, dëmton, ose e rrezikon atë person. Dhuna fizike përfshin një gamë të gjerë sjelljesh si gërvishtjet, shtyrjet, hedhjet, kapjet me forcë, kafshimet, vënien e duarve në fyt, pickimet, shpimet, shkuljet e flokëve, përdredhjet e krahut, shuplakat, shtrëngimin me forcë, goditjet, rrahjet, goditjet me shkelma, djegiet, goditjet me thikë, shtrëngimi i fytyrës/mbytjet. Dhuna fizike mund të përfshijë edhe përdorimin e madhësisë trupore dhe të forcës, mjeteve të kufizimit të lirisë dhe/ose armëve nga ana e një personi (p.sh., armë zjarri, thikë apo ndonjë objekt tjetër) për të fituar dhe mbajtur kontrollin mbi një person tjetër.”

Dhunë seksuale, konsiderohet: “Çdo akt seksual, përpjekje për të kryer një akt seksual, komente ose seksuale të padëshiruara, ose çdo veprim tjetër kundrejt seksualitetit të një personi duke përdorur shtrëngim, nga cilido person pavarësisht nga marrëdhënia e tyre me viktimën, në çdo mjedis, duke përfshirë por pa u kufizuar në shtëpi dhe punë. Shtrëngimi mund të mbulojë një spektër të tërë të shkallëve të forcës. Përveç forcës fizike, mund të përfshijë kërcënime psikologjike, presion ose kërcënime të tjera.

Mund të ndodhë edhe kur personi i sulmuar nuk është në gjendje të japë pëlqimin - për shembull, kur është i dehur, droguar, në gjumë ose mendërisht i paaftë për të kuptuar situatën. Dhuna seksuale përfshin përdhunimin, të përkufizuar si shtrëngim fizik edhe nëse në masë të vogël.

Dhuna ndaj grave në këtë dokument: “Kuptohet si shkelje e të drejtave të njeriut dhe një formë diskriminimi kundër grave dhe nënkupton të gjitha aktet e dhunës gjinore që çojnë ose mund të çojnë në dëmtim ose vuajtje fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike për gratë, duke përfshirë kërcënime për kryerjen e këtyre akteve, shtrëngim ose heqje arbitrare të lirisë, qoftë nëse ndodh në jetën publike ose private. Dhuna ndaj grave përfshin lloje të ndryshme të dhunës që pësojnë gratë, të rejat dhe vajzat, si dhunën në familje, dhunën nga partneri intim, dhunën seksuale nga një person jo-partner intim, ngacmimin seksual, martesën e detyruar, abortin dhe sterilizimin e detyruar, përndjekjen, krimet në emër të nderit, trafikimin dhe praktika të dëmshme si gjymtimi i organeve gjenitale femërore.”

Dhunë me bazë gjinore, konsiderohet: “Dhuna që drejtohet ndaj një gruaje për shkak se është grua ose që ndikon tek gratë në mënyrë disproporcionale.” Ajo përbën një shkelje të së drejtës themelore për jetesë, liri, siguri, dinjitet, barazi ndërmjet grave dhe burrave, mosdiskriminim dhe integritet fizik dhe mendor.

Dhunë nga partneri intim, konsiderohet: “Çdo sjellje në një marrëdhënie intime që shkakton lëndim fizik, psikologjik ose seksual të personave në një marrëdhënie, përfshirë veprime të agresionit fizik, detyrimit seksual, abuzimit psikologjik dhe sjelljes së kontrolluar.”

Dhunë në lidhje dashurie: “Modele të sjelljeve abuzive, përfshirë abuzimin emocional, fizik, seksual dhe financiar të përdorura për të ushtruar pushtet dhe kontroll tek partneri në lidhjen dashurore.”

Në mënyrë të ngjashme, Instituti European për Barazinë Gjinore e përkufizon dhunën në lidhjen dashurore si *“lloji i dhunës nga ana e partnerit intim që ndodh midis dy personave në një marrëdhënie të ngushtë.”*

Sulm seksual konsiderohet: “Akt seksual me apo pa kontakt fizik, i kryer nga një individ pa pëlqimin e viktimës ose, në disa raste, dhe veçanërisht kur janë të përfshirë fëmijët, përmes manipulimeve emocionale ose shantazhit. Është një veprim që e detyron një person t’u nënshtrohet dëshirave të një personi tjetër përmes shpërdorimit të pushtetit, përdorimit të forcës, detyrimit, ose kërcënimeve.”

Sulmi seksual shkel të drejtat themelore të viktimës, përfshirë të drejtën për integritet fizik dhe psikologjik dhe sigurinë e personit.

“Akt seksual me kontakt fizik” përfshin: përdhunimin/marrëdhënien seksuale me penetrim, përpjekjet për të kryer marrëdhënie seksuale me penetrim/tentativë për përdhunim, prekjen/kontaktin seksual. “Akt seksual pa kontakt fizik”, përfshin: ngacmimin seksual, ekspozimin e detyruar ndaj akteve seksuale (pornografi apo një akt seksual që po kryhet),

ekspozimin apo zbulimin e organeve gjenitale, nxitjen e një fëmije të prekë trupin e tij/saj apo të masturbohet, bërja e një regjistrimi vizual të një natyre seksuale të një fëmije.

Dhuna ndaj vajzave dhe grave është një fenomen shqetësues i kahershëm në kontekstin shqiptar dhe në të gjithë botën. Ajo i referohet dhunës fizike, seksuale, psikologjike dhe ekonomike (përfshirë frikësimin, vuajtjen, detyrimin, privimin e lirisë brenda familjes ose në komunitetin e gjerë, ngacmimin seksual etj.)⁴² Në Shqipëri, Anketa për Dhunën nga Grave dhe Vajzave tregoi 1 në 2 gra, ose 52.9 % e përgjigjedhëneve pohuan se kanë përjetuar të paktën një herë dhunë gjatë jetës së tyre, dhe 36.6 % prej tyre se aktualisht ishin duke përjetuar dhunë. Format më të shpeshta të dhunës janë përjetuar dhe përjetohe gjatë një lidhjeje dashurie ose në familje dhe ushtrohen nga partneri intim. Forma më e shpeshtë e dhunës në familje nga partneri intim është kontrolli shtrëngues, pasuar nga dhuna psikologjike dhe dhuna fizike dhe/ose ajo seksuale.⁴³ Të mbijetuarat e dhunës seksuale kanë pasoja serioze në shëndetin e tyre fizik dhe mendor, në shëndetin riprodhues dhe seksual, të cilat mund t'i vuajnë për një kohë shumë të gjatë.

Një studim i vitit 2020 nga organizata AWEN ka treguar se pjesa më e madhe e përgjigjedhëne/ëve mendojnë se dhuna seksuale është një fenomen i përhapur në Shqipëri (80 %), e ushtruar nga partnerët, persona të besuar ose të panjohur, edhe pse kishte ende paqartësi në lidhje me përkufizimin e dhunës seksuale. I njëjti studim tregoi se thuajse 1 në 10 vajza/gra përgjigjedhëne janë detyruar që të kryejnë marrëdhënie seksuale për herë të parë. Vajzat kishin 3 herë më shumë mundësi që të kenë frikë të kryejnë marrëdhënie seksuale për shkak të frikës nga partneri/ish – partneri. Të paktën 15 % e përgjigjedhëne/ëve thanë se nuk kanë dalë jashtë shtëpisë ose një vendi tjetër vetëm për shkak të frikës, dhe që kishin frikë të qëndronin vetëm me një person tjetër për shkak të pasigurisë dhe frikës së një sulmi seksual⁴⁴.

Një studim i mëparshëm i së njëjtës organizatë e mbështet këtë gjetje. Sipas tij, ka një nivel të ulët të ndërgjegjësimit për format e ndryshme të dhunës seksuale në Shqipëri dhe një frikë të lartë nga paragjykimet dhe nga fajësimi i viktimës (vajzave dhe grave) për atë që ka ndodhur.⁴⁵ Sa i përket adoleshentëve të moshës 16 – 19 vjeç një studim tjetër tregoi se 22 % prej tyre kanë patur të paktën një eksperiencë të dhunës në marrëdhëniet intime. Dhuna u raportua më shumë nga vajzat (28 %) sesa nga djemtë (20 %).⁴⁶

⁴² IDRA dhe UNWOMEN (2018). Sexual harassment and other forms of gender based violence in public spaces in Albania. E marrë nga: <https://www.idracompany.com/en/news-publications/news/un-WOMEN2019> e aksesuar në shtator 2022.

⁴³ INSTAT (2019). Dhuna ndaj Grave dhe Vajzave në Shqipëri. Vrojtim kombëtar me bazë popullatën 2018. INSTAT: Tiranë

⁴⁴ Dhëmbo E., Duci V., (2021) Dhuna në marrëdhëniet intime dhe dhuna seksuale tek të rinjtë në Shqipëri, AWEN, 2021.

⁴⁵ IDRA dhe UNWOMEN (2018). Sexual harassment and other forms of gender based violence in public spaces in Albania. Available at: <https://www.idracompany.com/en/news-publications/news/un-WOMEN2019> aksesuar në Shkurt 2022.

⁴⁶ Dhëmbo E., Duci V., (2021) Dhuna në marrëdhëniet intime dhe dhuna seksuale tek të rinjtë në Shqipëri, AWEN, 2021. <https://awenetwork.org/wp-content/uploads/2021/07/AWEN-Dhuna-AL-pages-webcompressed.p>

Dy studime të mëparshme të vitit 2019 janë në të njëjtën linjë, duke treguar kështu se fenomeni ka ekzistuar dhe vazhdon të jetë shqetësues. Studimi kombëtar për dhunën kundër vajzave dhe grave ku ishin përfshirë gra të rritura të moshave 18 – 74 vjeç (2019) ka treguar se gjysma e grave të intervistuar kishin përjetuar dhunë në familje. Gjithashtu, ky studim gjeti se gratë që kishin përjetuar abuzim seksual në fëmijëri kishin gjasa një e gjysmë herë më shumë për të përjetuar dhunë me bazë gjinore si të rritura. Rreth 3 % e grave raportuan të jenë abuzuar seksualisht si në fëmijëri. OSBE – ja në vitin 2019 realizoi një studim mbi mirëqenien dhe sigurinë e grave në Shqipëri. Aty rezultoi se 53 % e grave të ngacmuara seksualisht nuk kishin folur me askënd për përvojën e tyre. Në rastet kur kishin folur për ngacmimet seksuale që kishin përjetuar, ato rëndom kishin zgjedhur miqtë ose anëtarët e familjes⁴⁷.

Raporti i Prokurorisë së Përgjithshme për vitin 2021 tregoi se ka një rritje të procedimeve penale në shkallë vendi për krime seksuale me 16 %, ndërsa procedimet e dërguara në gjykatë janë rritur me 48 %. Pjesa dërmuese e të pandehurve janë burra (97 %) kur një përqindje prej 5.7 % janë nën moshën 18 vjeç.⁴⁸

Disa akte të dhunës seksuale mund të jenë të fshehura ose ambige, çka e bën të vështirë të kuptuarit e saktë nëse kemi të bëjmë ose jo me dhunë seksuale. Përkufizimet e dhunës seksuale ose të sjelljeve shtrënguese mund të variojnë shumë ndërsa studiohet fenomeni. Ilson dhe Miller (2016) arritën në përfundimin se 60 % e vajzave të reja që ishin viktimat të dhunës seksuale nuk e konsideronin eksperiencën e tyre si përdhunim dhe nuk mendonin se ishin viktimat të dhunës seksuale. Ato përdornin termin “seks i keq” ose “keqkuptim/komunikim jo i mirë” për të përshkruar eksperiencat e tyre. Shkalla e përdhunimit të “paidentifikuar” ishte më e lartë mes vajzave të reja⁴⁹.

Një studim tjetër ka konkluduar se sa më afër të jetë viktimat me abuzuesin aq më pak mundësi ka që të konsiderojë një veprim si dhunë seksuale⁵⁰.

Përgjatë viteve të fundit kuadri politik dhe ligjor për dhunën seksuale kundër vajzave dhe grave është përmirësuar disi. Megjithatë, ka ende fusha ku legjislacioni ka mungesa si për shembull në situata që nuk përfshijnë dhunën në familje, përfshirë forma të dhunës seksuale, dhe nuk është në përputhje me standardet ndërkombëtare për rastet e përdhunimit.⁵¹

⁴⁷ OSCE (2019). Mirëqenia dhe siguria e grave në Shqipëri. OSCE: Tiranë

⁴⁸ Prokuroria e Përgjithshme (2021). Raport i Prokurorit të Përgjithshëm mbi gjendjen e kriminalitetit për vitin 2021. Prokuroria e Përgjithshme: Tiranë.

⁴⁹ Wilson, L. C., Miller, K. E. (2016). Meta-analysis of the prevalence of unacknowledged rape. *Trauma, Violence, & Abuse*, 17, 149-159.

⁵⁰ Orchowski, L. M., Untied, A. S., Gidycz, C. A. (2013). Social reactions to disclosure of sexual victimization and adjustment among survivors of sexual assault. *Journal of Interpersonal Violence*, 28, 2005-2023.

⁵¹ INSTAT (2019). Dhuna ndaj Grave dhe Vajzave në Shqipëri. Vrojtim kombëtar me bazë popullatën 2018. INSTAT: Tiranë.

Në pjesën e gjetjeve të këtij Raporti, evidentohen, ndër të tjera, se:

- Ndërgjegjësimi dhe të kuptuarit e dhunës seksuale dhe ngacmimit seksual nuk janë procese të lehta në Shqipëri. Studimet e mëparshme kanë treguar se shpesh njerëzit nuk kanë informacion për dhunën ose ngacmimin seksual, veçanërisht në rastet e dhunës seksuale në marrëdhëniet intime.⁵² Vajzat dhe gratë pjesëmarrëse në këtë studim pohuan se nuk kanë qenë të informuara për dhunën seksuale ose ngacmimit seksual as në shkollë dhe as nga familjet e tyre. Në shumë raste diskutimi për çështje të tilla në familje konsiderohej “turp”, diçka që i linte pjesëmarrëset në errësirë.
- Përhapja e fenomenit të dhunës seksuale perceptohej si e madhe dhe e shtrirë në të gjithë Shqipërinë, me tendencë drejt përkeqësimit. Pjesëmarrëset në fokus grupe kanë përshkruar raste të ndryshme të abuzimit seksual që janë bërë mediatike, por edhe raste të njohura nga rrethi i tyre shoqëror dhe më gjerë/afër.

.....

- Informimi është shumë i rëndësishëm si për parandalim ashtu edhe për raportim, kërkimin e ndihmës dhe për parandalimin e ri-viktimizimit. Këtu është e rëndësishme të nënvijëzohet karakteri shumë-planësh i asaj që kuptohet me informim. Disa pjesëmarrës në studim u kujdesën të theksojnë se nuk mjafton vetëm informacion dhe ndërgjegjësim lidhur me atë që është e gabuar dhe që duhet t’i shpëtosh, por edhe si të dalësh prej situatave të ngacmimit dhe dhunës seksuale. Një nga të mbijetuarat e dhunës, me një eksperiencë relativisht të gjatë në një strehëz për gratë e mbijetuara nga dhuna e vuri theksin tek mungesa e informacionit dhe ndërtimit të kapaciteteve të të mbijetuarave të dhunës për t’ia dalë vetë, gjë që do të parandalonte ri-viktimizimin e tyre.
- Shpeshherë të mbijetuarat e dhunës vijnë nga kontekste familjare dhe sociale ku mbizotëron një mentalitet patriarkal, ku stereotipat gjinore mbeten të ngurtë dhe fajësimi i viktimës predominon. Në këto qëndrime, diferencat gjinore janë më të ngushta, pasi fajësimin e viktimës e artikulojnë dhe manifestojnë edhe gratë. Në një nga diskutimet në fokusgrupe një pjesëmarrëse do të shprehej: *“Mund të jetë nismëtari mashkulli, por gjithmonë fajtori është femra.”* Sado kategorike dhe irracionale të tingëllojë kjo, evidenca nga rastet e studiuara konfirmojnë se fajësimi i viktimës vijon të mbetet një problem kritik në çështjet e dhunës dhe ngacmimit seksual, dhe se ai nuk njuh limit as kur viktimë është preh e dhunë seksuale dhe kur ajo është një fëmijë që sapo ka filluar klasën e parë.
- Duke fajësuar viktimën, një pjesë kërkojnë ta gjejnë “zgjidhjen” në masa kufizuese për to dhe jo në përballjen dhe adresimin e dhunuesit. Kjo vjen në formën e kërkesave për të mos folur, për të falur, apo për të kufizuar lirinë e vajzës/gruas së dhunuar.
- Informimi dhe ndërgjegjësimi për dhunën seksuale dhe ngacmimin seksual ishte i pamjaftueshëm dhe konfuz. Ende në shkolla diskutimi i hapur i çështjeve seksuale konsiderohet “tabu” duke shtuar kështu në ngarkesën e stereotipave që mbart kjo çështje. Kur është fjala për abuzimin e djemve – një fenomen që u evidentua në kë të studim –

⁵² Dhëmbó E., Duci V., Dhuna në marrëdhëniet intime dhe dhuna seksuale tek të rinjtë në Shqipëri, AWEN, 2021

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr.27, Kodi Postar 1001, Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: info@kmd.al, web: www.kmd.al

informimi dhe përpjeka për parandalim është akoma më i pakët. Duke anashkaluar informimin, ndërjegjësimi – parandalimi - ndërhyrja dhe kërkesa e ndihmës bëhen tejmase të vështira. Kështu, duket se arsimimi dhe mirë-informimi janë thembra e Akilit për parandalimin, kërkimin e ndihmës, rimëkëmbjen dhe mos-riviktimizim. Format e dhunës ose abuzimit seksual varionin nga prekjat dhe ngacmimet pa prekje deri tek përdhunimi. Shumë raste të tilla vazhdojnë të ndodhin në rrethin e besimit, atje ku si fëmijët ashtu dhe të rriturat vajza ose gra e kanë më të vështirë për të kërkuar ndihmë, veçanërisht nën presionin familjar dhe të komunitetit.

- Abuzimi, dhuna seksuale dhe ngacmimi seksual nuk janë fenomene ishullore, ato ndodhin në një kontekst familjar, komunitar dhe shoqëror. Në këtë analizë të situatës ato ishin prezentë në familje me probleme të tjera sociale, si përdorimi alkoolit dhe drogave, kriminaliteti, dhuna e formave të tjera në familje.
- Mendësia patriarkale është ende shumë prevalente në shoqërinë shqiptare, veçanërisht në zonat rurale, por jo vetëm. Prezenca e stereotipave gjinore të forta shton sfidat në procesin e raportimit dhe kërkimit të ndihmës. Paragjykimet e tipit “sido që të bjerë monedha ti je fajtores” ishin të pranishme thuajse në të gjitha rastet. Kur vajzat ose gratë i nënshtroheshin dhunës ose abuzimit seksual të tjerët i gjykonin, kur ato vendosnin që të denonconin dhunuesit sërish janë gjykuar. Solidarizimi i komunitetit ishte inekzistent, duke nxjerrë në pah vështirësitë për të kapërcyer mendësinë patriarkale në këto komunitete. Stereotipat dhe paragjykimet gjinore duket se janë të pranishme dhe tek institucione si policia, gjykata dhe në shkolla duke e bërë kështu më të vështirë kërkimin e ndihmës dhe duke riviktimizuar viktimën.
- Pavarësisht përpjekjeve të deritanishme, ka një nevojë të madhe dhe të shtrirë në të gjithë territorin e vendit, në zona urbane apo rurale, për më shumë informim dhe edukim për çështjet e dhunës me bazë gjinore në përgjithësi dhe asaj seksuale në veçanti. Për sa kohë dhuna seksuale shfaqet që herët edukimi për t’u mbrojtur dhe parandaluar nuk është kurrë shumë i parakohshëm.

Bazuar në analizën dhe të dhënat statistikore sipërcituar, Komisioneri vëren se, është fakt që në Shqipëri gratë/vajzat ndeshen me një sërë veprimesh paragjyquese e diskriminuese, shoqëruar dhe me një gjuhë të urrejtjes, dhunë e lëndime. Barazia dhe mbrojtja nga diskriminimi “*de-jure*” jo gjithmonë respektohet dhe shoqërohet edhe me drejtësi “*de-facto*”.

Neni 3/8 i ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, ndalon gjuhën e urrejtjes, në çdo formë të shprehjes në publik dhe me çdo mjet. Komisioneri vlerëson se, në rastin objekt shqyrtimi, shprehjet e realizuara nëpërmjet fjalëve dhe në mënyrë publike, (pasi gjuha e përdorur nga Av. S. N, në emisionin “Më lër të flas”, të datës 14.04.2023, transmetuar në televizionin kombëtar Top Channel-objekt shqyrtimi në këtë çështje) janë bërë në një platformë publike, siç janë mediat audiovizive, përfshihen në mjetet e përhapjes së gjuhës së urrejtjes.

Av. N prapësoi se, nuk kishte bërë në asnjë moment thirrje nxitëse për të ngjallur urrejtje por deklaratat e tij ishin për të ngritur figurën e gruas, dhe se kishte cituar një autor të huaj dhe shumë të njohur të së drejtës penale anglo-sanksone.

Në lidhje me këtë pretendim, Komisioneri thekson se, sikurse rezulton edhe nga përkufizimi i gjuhës së urrejtjes dhe nxitja e urrejtjes mund të rezultojë edhe nga deklarata që shqetësojnë, fyejnë, stigmatizojnë ose përbëjnë një stereotip negativ dhe që bazohen në një nga shkaqet e mbrojtura duke përfshirë edhe shkaqet gjinore.

Në këtë kontekst, GJEDNJ në çështjen Féret kundër Belgjikës (*Féret kundër Belgjikës, Kërkesa nr. 15615/07, 16 korrik 2009*) është shprehur se: “..... nxitja e urrejtjes nuk nënkupton domosdoshmërisht thirrje për kryerjen e akteve të dhunës apo ndonjë akti tjetër të paligjshëm. Sulmet ndaj grupeve të veçanta të popullsisë të kryera nëpërmjet fyerjes, talljes apo shpifjes, mund të jenë të mjaftueshme për autoritetet për të përligjur trajtim të menjëhershëm dhe efikas kundër shprehjeve raciste, përballë lirisë së shprehjes të ushtruar në mënyrë të papërgjegjshme.....”

Gjuha e urrejtjes konsiderohet e tillë edhe kur efekti që prodhon apo krijon pritshmërinë se mund të nxisë drejt kryerjes së akteve të dhunës, frikësimit armiqësisë apo diskriminimit.

Për të vlerësuar nëse ekziston rreziku që aktet e promovuara ose të nxitura nga gjuha e urrejtjes të ndodhin, Komisioneri ka marrë në konsideratë rrethanat e mëposhtme, në përputhje me frymën e Rekomandimit Nr. 15 të ECRI-t.

Duke ju referuar përmbajtjes së diskutimeve, z. N, ndër të tjera, është shprehur se:

“E dini ju se çfarë thotë ligji anglo-sakson? Ata kur dënojnë një person që përdhunon një vajzë, grua apo zonjë, marrin parasysh rezistencën e saj. A i ka rezistuar ajo ndaj kësaj tentative apo jo. E dini pse? Sepse gratë janë natyra më të dobëta, ata nuk rezistojnë dot, madje ndjejnë kënaqësi dhe në momentin që përdhunohen dhe më pas dorëzohen.”⁵³ (citim nga biseda e z. N në emision)

Debati dhe diskutimi për çështje të ndryshme është i nevojshëm veçanërisht për tema apo çështje sensitive, që janë në interes të opinionit të gjerë. Diskutime mbi informacione jo të bazuara shpesh çojnë në krijimin e paragjyqimeve dhe stigmatizimin e personave për shkak të gjinisë. Ligjërime apo fjalime të tilla, të cilat i portretizojnë femrat si “më të dobëta nga natyra se meshkujt”, në rastin konkret, stimulojnë frikën, nxisin qëndrime negative, nxisin diskriminimin dhe për këtë arsye ato janë në kundërshtim me ligjin. Gjuha e përdorur nga z. N etiketon gratë/vajzat në një mënyrë të gabuar, duke i vendosur ata në pozita paragjyquese, duke i stereotipizuar, duke keqinformuar publikun, gjë e cila mund të passjellë edhe viktimizim të tyre.

Gjuha e përdorur nga z. N, është përcjellë në një kontekst të një debati të lindur si pasojë e diskutimit të një tematike krejtësisht tjetër, atë të tradhëtisë në çift. Si pasojë e këtij debati, nga

⁵³ <https://www.youtube.com/watch?v=hmDXtt8I77o>

pala ankuese janë konstatuar në rrjetet sociale, komente e shprehje fyese dhe diskriminuese kundrejt grave/vajzave. Komisioneri ka konstatuar se gjuha e përdorur ka nxitur komente nga persona të ndryshëm në platformat sociale si “Youtube”, “Facebook”, etj, komente të cilat janë fyese, paragjykuese, denigruese dhe krejtësisht të papërshtatshme.

Gjuha e përdorur dhe e shpërndarë në një mjedis shoqëror ku paragjykimet dhe stereotipizimi i grave si gjina më e dobët dhe e nënshtruar, janë të theksuara dhe paraqesin një fenomen shqetësues, shton mundësinë që të nxitet diskriminimi ndaj grave/vajzave nga njëra anë, dhe nga ana tjetër të rrezikojë keqinformimin e keqndikimin tek ajo kategori meshkujsh që mund të “marrin të mirëqenë” deklarin e z. N, se:

“...Është dhe scherzo e vajzës që bën sikur jo. Të akuzojnë X për përdhunim, në bazë të së drejtës penale angleze, ata matin sa e ke segmentin e rezistencës. Sepse vjen një moment i caktuar që femra...pasi femra është shtrënguar për përdhunim, dorëzohet nga kënaqësia. Prandaj duhet të jetë e lartë rezistenca që të dënohet.

...gratë janë natyra më të dobëta, ata nuk rezistojnë dot, madje ndjejnë kënaqësi dhe në momentin që përdhunohen dhe më pas dorëzohen.”

Pra, duke lënë shteg për hamendësimin e publikut që e ndjek, të faktit se:

- Ose gruaja/vajza në një farë pike e momenti, për faktin se nga natyra është më e dobët se mashkulli, kur shtrëngohet e detyrohet të ketë një raport dashuror e marrëdhënie seksuale, dorëzohet e madje edhe ndjen kënaqësi;
- Ose që një grua/vajzë, të akuzojë një person për përdhunim, duhet që të provojë shkallën e lartë të rezistencës së saj.

Bazuar në sa më lart, Komisioneri gjykon se, ilustrimi i përdorur nga z. N, lidhur me faktin se *si* dhe *kur* konsiderohet se ka ndodhur një akt përdhunimi, sipas të drejtës anglo-sanksone (duke cituar edhe autorin J. Herring), pa kontestuar vërtetësinë apo jo të kësaj reference, është përdorur për të shtjelluar mendimin e tij gjatë bisedës me të ftuarit e tjetër dhe prezantuesit e emisionit në fjalë.

Në gjykimin e rasteve të dhunës seksuale, palët duhet të marrin parasysh jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, e në këtë kontekst, çështjen M. C kundër Bullgarisë: “Qëndrimi i ngurtë i ndjekjes penale ndaj veprave seksuale, duke kërkuar për prova të rezistencës fizike në të gjitha rrethanat, rrezikon të lejë të pandëshkuara disa lloje përdhunimi dhe, në këtë mënyrë, rrezikon mbrojtjen efektive të autonomisë seksuale të individit.”⁵⁴

Nga sa më sipër, rezulton se një përkufizim i ngushtë, në përkufizimin e dhunës seksuale bazuar tek forca, përfshirë përdhunimin, duke kërkuar për rezistencë, rrezikon të dështojë në mbrojtjen e të drejtave të grave për integritet trupor dhe autonomi seksuale. Gjithashtu, duhet të sigurohet që

⁵⁴ Referoju paragrafit 191 të raportit shpjegues të GREVIO-s për Shqipërinë.

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr.27, Kodi Postar 1001, Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: info@kmd.al, web: www.kmd.al

ndjekja penale e këtyre veprave të mbështetet në një vlerësim të ndjeshëm ndaj kontekstit të evidencave për të përcaktuar rast pas rasti nëse viktimat ka dhënë apo jo lirisht pëlqimin për aktin seksual. Në analizë duhet të njihen gama e gjerë e reagimeve të sjelljes ndaj dhunës seksuale dhe përdhunimit që viktimat mund të shfaqin dhe ajo nuk duhet të bazohen në supozime të sjelljes tipike në këto situata, e as të ndikohet nga stereotipat gjinor dhe mitet rreth seksualitetit të grave dhe burrave⁵⁵.

Së fundmi, dhuna seksuale duhet të përfshijë dhunën seksuale në familje. Historikisht, legjislativi i shumë vendeve e ka shpërfillur në mënyrë të nënkuptuar ose të shprehur përdhunimin martesor. Sipas nenit 43 të Konventës, kriminalizimi i veprave seksuale zbatohet pavarësisht nga natyra e marrëdhënies ndërmjet dhunuesit dhe viktimës.

Përdorimi i forcës është një element themelor i krimit të përdhunimit me një grua të rritur, përveç rasteve të përdhunimit ndërmjet bashkëshortëve ose bashkëjetuesve, ku vepra bazohet në mungesën e pëlqimit⁵⁶.

Vetëm në rastet e shfrytëzimit të personave me aftësi të kufizuara fizike ose mendore, frikësimit me anë të përdorimit të një arme ose shpërdorimit të detyrës apo besimit, është përjashtuar mundësia e dhënies lirisht të pëlqimit, pa kërkesën e përdorimit të forcës.

Dispozita shqiptare e përdhunimit jep një përkufizim të bazuar në forcë dhe nuk arrin të përmbushë kërkesat e Konventës.

Për rrjedhojë, viktimat ka barrën e provës për të provuar dhunën/rezistencën. Në rastet kur viktimat është e paaftë ose nuk dëshiron të demonstrojë apo provojë masën e kundërshtimit a rezistencës, kjo gjë bën që rastet e përdhunimit të mos raportohen ose të mos ndiqen penalisht. Për më tepër, nuk ka evidencë të një interpretimi të gjerë nga gjykatat të elementit përbërës të forcës, gjë që pengon viktimat të kenë pengesa të rëndësishme të qasjes në drejtësi.

Në këtë kontekst, Komisioneri vëren se, deklarata të tilla të bëra nga një avokat e ekspert i njohur i legjislativës në Shqipëri, siç është Av. N, mund të keqinformojnë e krijojnë bindje të gabuara tek publiku që i ndjek lidhur me perceptimin e konceptit të përdhunimit në vetvete, duke prezumuar se, një femër që i nënshtrohet një akti të tillë të rëndë si përdhunimi, nëse nuk arrin të provojë rezistencën e madhe fizike kundrejt personit që kryen aktin, e pranon atë dhe në një farë mënyre konsiderohet fajtorë se nuk ka bërë një rezistencë të madhe fizike (gjë e cila nuk ka një masë matëse), ose në rastin më të keq, prezumon se e ka dashur dhe pranuar një akt të tillë.

Në të gjitha rastet, fajësia e paragjykimi peshon mbi gratë dhe vajzat, por nga ana tjetër, krijohet përshtypja për meshkujt se, veprimet e aktet e tyre seksuale kundrejt një gruaje/vajze, pa pëlqimin

⁵⁵ Shiko paragrafin 192 të raportit shpjegues, sipërcituar.

⁵⁶ Neni 102, i Kodit Penal, të ndryshuar.

e saj, nëse nuk pasohen më një rezistencë të madhe fizike, nuk konsiderohen “përdhunim” dhe nuk mund të akuzohen prej tyre për një vepër të tillë.

Komisioneri vlerëson se, një ndikim i tillë është shumë i gabuar dhe i dëmshëm për publikun që i drejtohet, duke patur në konsideratë kontekstin shqiptar historik, kulturor, social, familjar, nivelin e arsimimit, etj.

Duke qenë një avokat i njohur dhe personazh i dashur dhe shumë i njohur publik, z. N, ka aftësi për të ndikuar tek një publik i gjerë.

Në mënyrë të veçantë rezulton se z. N, është person shumë aktiv në jetën publike nëpërmjet prezencës së tij në media. Duke u bazuar tek statusi i tij dhe ndikimi që ai ka, ai mbart detyrime të shtuara, në raport me persona të tjerë të cilët nuk kanë një profil publik apo status të tillë, për të treguar një kujdes të shtuar në lidhje me gjuhën që përdor gjatë ushtrimit të lirisë së shprehjes. Për shkak të statusit dhe ndikimit që ka tek të tjerët, ai duhet të tregojë një përgjegjshmëri më të madhe në lidhje me gjuhën e përdorur për të transmetuar qëndrimet, mendimet apo mesazhet e ndryshme, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë, qoftë në mënyrë të nënkuptuar.

Komisioneri gjykon se nuk është e gabuar të informohet publiku dhe të diskutohen tema sensitive që prekin grupime e shtresa të ndryshme të shoqërisë, por veshja dhe referimi i mendimeve apo perceptimeve personale, sidomos me konotacion negativ, apo të vendosur në një kontekst të gabuar, dhe që mund të shërbejë për keqinformim a keqedukim, përbën një qëndrim të gabuar dhe krijon premisa për paragjykime si dhe streatipe negative.

Në këtë kuptim, referimi e citimi i z. N se, *vjen një moment i caktuar që pasi femra është shtrënguar për përdhunim, dorëzohet nga kënaqësia. Prandaj duhet të jetë e lartë rezistenca që të dënohet...gratë janë natyra më të dobëta, ata nuk rezistojnë dot, madje ndjejnë kënaqësi dhe në momentin që përdhunohen dhe më pas dorëzohen,* përbën një qëndrim jo profesional, jo informues, paragjykes dhe nga ana tjetër krijon negativitet kundrejt grave e vajzave në përgjithësi, e në veçanti kundrejt asaj kategorie që mund të jenë viktima të përdhunimit, duke i shqetësuar ato dhe duke krijuar premisa për sjellje diskriminuese kundrejt tyre.

Në çështjen në fjalë, Komisioneri mban parasysh edhe mjetin nëpërmjet të cilit janë përhapur deklaratimet e z. N në këtë emision. Komisioneri vlerëson se, përhapja e ligjëratave të tilla nëpërmjet medias audiovizive dhe mediave sociale nëpërmjet internetit, janë shumë më e fuqishme dhe arrin te një publik shumë të gjerë. Mediat sociale apo interneti, siç është cituar edhe në Rekomandimin CM/Rek (2022)16, të Komitetit të Ministrave, kanë një mundësi shpërndarje si kurrë më parë në të gjithë botën brenda pak sekondash.

Komisioneri vlerëson se, gjuha e përdorur nga z. N, krijon në radhët e publikut dhe veçanërisht të atyre personave që nuk janë të mirë informuar, ndjenja keqkuptimi, paragjykim, stereotipizim, të gruas në përgjithësi, e tek disa ndjenja urrejtje ndaj grave e vajzave që janë viktima të

përdhunimit. Në çështjen Féret kundër Belgjikës⁵⁷, GJEDNJ, ka mbajtur qëndrimin se: “.....një ligjëratë e tillë në mënyrë të paevitueshme do krijojë mes publikut – e veçanërisht mes atyre anëtarëve të publikut që nuk janë të mirinformuar – ndjenja keqkuptimi, madje refuzimi e te disa, edhe urrejtje

Gjuha e përdorur dhe qëndrimi i z. N, për sa më sipër, pa u sqaruar, distancuar, shpjeguar në moment ose dhe më vonë prej tij, edhe pse nuk është një kërcënim i drejtpërdrejtë ndaj një personi të caktuar, mund të kuptohet si qëndrim a gjuhë që nxit urrejtje, apo paragjykim të grave e vajzave.

Për këtë arsye, Komisioneri vlerëson se për shkak të paragjykimit e stereotipizimit të vazhdueshëm që i bëhet figurës së gruas në shoqërinë shqiptare, është e nevojshme që të ndërmerren masa të menjëhershme për të ndaluar çdo përdorim të gjuhës së urrejtjes dhe për të siguruar mbrojtje efektive nga çdo formë diskriminimi.

Gjykata Evropiane e Drejtësisë, në çështjen e Firmës Feryn (*Centrum voor gelijkheid van kansen en voor racismebestrijding kundër Firmës Feryn NV, C-54/07, 10 korrik 2008*), ka mbajtur qëndrimin dhe ka pranuar se diskriminimi mund të shfaqet edhe në ato raste kur nuk mund të identifikohet një viktimë. Komisioneri vlerëson se në çështjen në fjalë, gjuha e përdorur përcjell një gjuhë urrejtje të pajustificuar, saqë edhe në mungesë të identifikimit të një individi konkret si viktimë diskriminimi, mosndëshkimi i një sjellje diskriminuese, do të cenonte rëndë arsyen e vetë ekzistencës së ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.

Ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 3, pika 8 parashikon se: “Gjuha e urrejtjes” është çdo formë e shprehjes në publik, me çdo mjet, e promovimit, nxitjes së denigrimit, urrejtjes ose shpifjes, çdo shqetësim, fyerje, stereotip negativ, stigmatizim ose kërcënim ndaj një personi ose grupi personash, si dhe çdo justifikim i të gjitha formave të shprehjes e bazuar në një listë joshteruese të shkaqeve, sipas nenit 1 të këtij ligji.”

Siç vërehet, në nenin e sipërcituar referohet “...çdo formë e shprehjes në publik, me çdo mjet...”, çka do të thotë që në kuptim të ligjit çdo mënyrë publike e të shprehurit që krijojnë premisën e parashikuar në këtë formë diskriminimi është dhe duhet hetuar. Aq e vërtetë është kjo sa është praktikë e gjerë e GJEDNJ që të hetojë dhe të shprehet edhe në rastet e përdorimit të gjuhës së urrejtjes me mjete tjera jo tradicionale si rrjete sociale, portale on line apo edhe komente nga përdoruesit.

Për këtë qëllim sjellim në vëmendje standardet e Këshillit të Evropës në lidhje me gjuhën e urrejtjes, nëpërmjet Rekomandimit nr. 15 i Politikës së Përgjithshme të ECRI-t “Për luftimin e gjuhës së urrejtjes”⁵⁸ (materiali në link), në bazë të cilit është mbështetur edhe

⁵⁷ Féret kundër Belgjikës, Kërkesa nr. 15615/07, 16 korrik 2009

⁵⁸ <https://rm.coe.int/ecri-general-policy-recommendation-no-15-on-combating-hate-speech-alba/16809eb58e>

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr.27, Kodi Postar 1001, Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: info@kmd.al, web: www.kmd.al

legjislatori shqiptar në përkufizimin e kësaj forme diskriminimi në Ligjin “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Po ashtu, edhe jurisprudencën dhe vendime konkrete të GJEDNJ-së në lidhje me format dhe mjetet e shprehura të gjuhës së urrejtjes dhe kuptimit të saj nga kjo gjykatë.⁵⁹

Në frymë të këtij rekomandimi dhe jurisprudencës së sipërcituar, shqetësimi lidhet me përdorimin e gjuhës së urrejtjes, pavarësisht nga mjeti i përdorur. Sidomos në rastet kur personi i prezumuar që ka përdorur gjuhë urrejtje e ka bërë këtë me zë dhe me figurë, i identifikuar me emër dhe mbiemër, në median audiovizive, në një televizion kombëtare, apo në platforma të tjera si Youtube apo Facebook, ku është aksesuar nga çdo njeri dhe shpërndarë nga një numër i konsiderueshëm personash.

Për sa më sipër, në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri vlerëson se përdorimi i shprehjeve të gjuhës seksiste dhe denigruese për shkak gjinie, ndaj grave/vajzave, nuk e justifikon moskërkimin e një ndjese publike apo shpjegimit të faktit nëse ai ka qenë i keqkuptuar në deklaratimet e tij, duke qartësuar qëndrimin e tij lidhur me sa është perceptuar në publik. Në këtë kuptim, përdorimi i saj referuar grave/vajzave, i ka vënë ato në pozita diskriminuese për shkak të gjinisë, në formën e gjuhës së urrejtjes. Komisioneri thekson faktin se përdorimi i një gjuhe të tillë përforcon stereotipe negative, stimulon veprime fyese, denigruese, kërcënuese dhe urrejtje ndaj grave/vajzave, aq më tepër kur përdoret në hapsira mediatike nga persona që bëjnë pjesë në jetën publike dhe kanë një numër të madh audience.

Në përfundim, në lidhje me përdorimin e gjuhës së urrejtjes, rëndësi ka që përdorimi dhe emetimi i saj, pavarësisht mjetit të përdorur, ka ndodhur ose/dhe vazhdon të ndodhë dhe krijon shqetësim në shoqëri e akoma më tepër në grupe shoqërore të konsideruara dhe të njohura si sitematikusht të diskriminuara.

Dhuna verbale, psikologjike dhe shprehje të gjuhës seksiste dhe denigruese janë të papranueshme dhe për më shumë të dënueshme kur përdoren në hapësira publike mediatike, në emisione me audiencë të gjerë dhe në fasha orare me rezonancë të lartë të popullsisë, ku përfshihen edhe fëmijët dhe të rinjtë.

⁵⁹ Çështja Jersild kundër Denimarkës 23 Shtator 1994 – Fragmente nga dokumentar;

Çështja Gündüz kundër Turqisë 4 Dhjetor 2003 – Debat televiziv;

Çështja Erbakan kundër Turqisë 6 Korrik 2006 – Fjalim publik;

Çështja Pavel Ivanov kundër Ruisë 20 Shkurt 2007 – Artikull i shkruar;

Çështja Féret kundër Belgjikës 16 July 2009 – Fletëpalosje;

Çështja Delfi AS kundër Estonisë 16 Qershor 2015 – Koment në një portal në internet;

Çështja Belkacem kundër Belgjikës 27 June 2017 – Komentë në Youtube;

Çështja Šimunić kundër Kroacisë 22 Janar 2019 – mesazhe në një ndeshje futbolli;

Çështja Beizaras dhe Levickas kundër Lithanisë 14 January 2020 – Komentë në Facebook;

Çështja Lilliendahl kundër Islandës 12 Maj 2020 – Komentë në një artikull on line;

Çështja Zemmour v. France 20 dhjetor 2022 – Deklaratë në emision televiziv;

Çështja Valaitis kundër Lithuanisë 17 January 2023 – Komentë në internet

Përfundimisht, duke marrë në konsideratë të gjitha aspektet e analizuar më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se, gjuha e përdorur nga S. N, përbën gjuhë urrejtje, për shkak të gjinisë. Mendimet dhe qëndrimet e shprehura prej tij, janë në tejkalim të lirisë së shprehjes dhe si të tilla ato nuk mund të gëzojë mbrojtje nga nenet 22 dhe 24 të Kushtetutës, nenet 9 dhe 10 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe neneve 18 dhe 19 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike. Për të gjitha arsytet e mësipërme, Komisioneri vlerëson se kufizimi i gjuhës së urrejtjes është i domosdoshëm dhe proporcional.

Në nenin 33, pika 10, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“Vendimi përmban rregullimet dhe masat e duhura, duke caktuar edhe një afat për kryerjen e tyre”, ndërsa mbështetur në nenin 33, pika 12, të po këtij ligji, përcaktohet se:

“Kur vendos masën, komisioneri siguron që ajo të jetë: a) e efektshme dhe parandaluese; dhe b) në përputhje me gjendjen që e shkaktoi vendosjen e masës.”

Ligji nuk ka përcaktuar masat që duhen ndërmarrë për rregullimin e situatës diskriminuese, atribut ky që është lënë në diskrecionin e Komisionerit. Në këtë kontekst, Komisioneri vendos rast pas rasti, se cilat janë rregullimet dhe masat e duhura që duhen marrë në mënyrë që të sigurojë mbrojtjen efektive nga diskriminimi të individëve që pretendojnë se janë viktimat e diskriminimit.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, masa e duhur për rregullimin e situatës diskriminuese duhet të jetë detyrimi i Av. S. N që të bëjë një deklaratë publike (verbale ose të shkruar) me anë të të cilës të distancohet nga përdorimi i gjuhës së urrejtjes dhe kërkimin e ndjesës për përdorimin e saj në bisedën e tij, në emisionin “Më lër të flas”, të datës 14.04.2023, në televizionin Top Channel, si dhe të evitohet në të ardhmen përdorimin e saj.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 32 dhe 33 pikat 10, 11 e 12, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Të deklarojë të përfunduar pa një vendim përfundimtar procedurën administrative për pjesën e ankesës që lidhet me pretendimet e ngritura kundër Televizionit Kombëtar Top Channel, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte filluar procedura hetimore kundrejt këtij subjekti.

2. Televizioni Kombëtar Top Channel, *rekomandohet* që të tregojë një kujdes të shtuar dhe të vazhdueshëm, për kontrollin dhe mos shpërndarjen e kontetit të materialeve të ndryshme televizive, të cilat mund të përbëjnë gjuhë urrejtje.
3. Gjuha e përdorur nga Av. S. N, transmetuar në emisionin “Më lër të flas”, të datës 14.04.2023, në televizionin kombëtar Top Channel, përbën diskriminim, në formën e “gjuhës së urrejtjes”, për shkak të gjinisë.
4. Në referim të pikës 2, të këtij vendimi, S. N, në cilësinë e personit i cili ka konsumuar sjelljen diskriminuese si më sipër, të bëjë një deklaratë publike (verbale ose të shkruar) me anë të të cilës të distancohet nga përdorimi i gjuhës së urrejtje dhe të evitojë në të ardhmen përdorimin e saj.
5. Në referim të nenit 33, pika 11, të Ligjit “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijani për këtë vendim, S. N, duhet të njoftojnë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e tij.
6. Në referim të nenit 33, pika 11, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të pikës 13, të po këtij neni.
7. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA